PROGRAMI I ZHVILLIMIT
PËR ZONËN PILOT
LAGJIA 5 MAJI
QYTETI ELBASAN

Bashkia Elbasan
Qendra Komunitare Rome

Co-PLAN

Cordaid
Mensen voor Mensen Nood-Vastenaktie



Ky botim u mundësua nga:
Co-PLAN
Instituti për Zhvillimin e Habitatit

me mbështetjen financiare të:
Cordaid Holandë

në kuadër të projektit:
"Hapa drejt një Shoqërie gjithëpërfshirëse në Elbasan, integrimi i grupeve të prekura në zhvillimin urban"

Autorë: Dritan Shutina, Manjola Duli, Olta Cakciri
Kuntribues përmbajtësorë: Darina Kokona, Djamanta Vito
Korrektimi letrar: Olta Cakciri

Realizimi Grafik:

Shtypur në: botime afrojdit

Përmbajtja e lëndës

FJALORTH 6

MIRËNJOHJE 7

PËRMBLEDHJE 8

1. PSE PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONËS PILOT? 11

2. CILAT JANË AVANTAZHET QË KRIJON PROGRAMI I ZHVILLIMIT? 13

3. PROCESI I HARTIMIT PROGRAMIT TË ZHVILLIMIT TË ZONËS PILOT 15
   3.1 Qëllimi dhe objektivat 15
   3.2 Përfshirja në nivelin politik dhe komunitar e aktorëve të interesuar 17
   3.3 Zgjedhja e Strategjisë 20
   3.4 Përparësitë e zhvillimit 21
   3.5 Ngritja e vetëdijes 23

4. PROFILI I ZONËS PILOT 25
   4.1 Karakteristikat Fizike 25
   4.2 Karakteristikat e popullsisë 26
   4.3 Zhvillimi ekonomik 26
   4.4 Edukimi 28
   4.5 Pronësia e tokës, strehimi, legalizimi 29
   4.6 Infrastruktura fizike në zonën pilot 32
   4.7 Mjedisi 35
   4.8 Aspektet sociale 36

5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË ZHVILLIMIT TË ZONËS PILOT 39

6. OBJEKTIVAT DHE PËRPARËSITË E ZHVILLIMIT 41

7. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME 43
   7.1 Konkluzione 43
   7.2 Rekomandime 43

SHTOJCË 47

Fjalorth

Romë – Një grup minoritar me origjinë nga India që është vendosur në Shqipëri rreth shekullit të pesëmbëdhjetë. Romët kanë gjuhën e tyre e cila është e ndryshme nga shqipja. Qeveria Shqiptare i njeh ata vetëm si minoritet gjuhësor.

Rajon – Nënndarje administrative e bashkive të Kategorisë I. Kryetari i rajonit emërohet nga kryetari i Bashkisë.

Fis – Anëtarë të një grupi minoritar që kanë marrëdhënie gjaku nga ana e prindërve.

Popullsi në lëvizje – Karakteristike për anëtarët e komunitetit rom të cilët, për shkak të kulturës së tyre, shpesh ndryshojnë vendbanim.

Zona pilot – Zona brenda lagjes "5 Maji", Elbasan, e përbërë nga një popullsi heterogjene, rome dhe jo rome, e përcaktuar si zona për zbatimin e projektit "Hapa drejt një Shoqërie gjithëpërfshirëse në Elbasan, integrimi i grupeve të prekura në zhvillimin urban".

Buxhetimi me Pjesëmarrje – Është një proces nëpërmjet të cilit autoritetet vendore ftojnë qytetarët të diskutojnë dhe vendosin së bashku se si do të shpërndahen fondet për investimet.

"Romano Sezi" – Organizatë rome me bazë komunitare e cila e zhvillon veprimtarinë e saj në lagjen "5 Maji", Elbasan. Kjo OBK është ngritur dhe asistuar nga Co-PLAN.

Mirënjohje

Procesi i hartimit të dokumentit "Programi i Zhvillimit të Zonës Pilot 'Lagjja 5 Maji', Qyteti Elbasan" u realizua midis muajve Janar - Tetor 2008. Hartimi i këtij programi zhvillimi u krye në saje të bashkëpunimit të Bashkisë Elbasan dhe Rajonit nr. 6 Elbasan me Qendrën Komunitare Rome, Shoqatën e Komunitetit "Romano Sezi" dhe me mbështetjen e CO-PLAN.

Formulimi i "Programit të Zhvillimit të Zonës Pilot 'Lagjja 5 Maji'" i detyrohet kontributit të katër grupeve të punës, në veçanti anëtarëve më aktivë të tyre të cilët kontribuuan në mënyrë domethënëse në nivel zone, si edhe mjaft pjesëtarëve të komunitetit të zonës pilot por edhe individëve të tjerë të cilët kontribuuan duke marrë pjesë në takimet e organizuara e duke ofruar informacionin, kohën dhe komentet e tyre. Falënderime edhe studentëve të cilët ndihmuan në mbledhjen e informacionit mbi zonën pilot. Falë këtyre kontributeve u bë e mundur arritja e objektivit të hartimit të planeve të veprimit.

FALËNDERIME PRA:

Organizatës Rome me Bazë Komunitare:
Enver Mustafaj, Nebi Mustafaj, Nimete Ademi, Përparim Sinani, Ferit Shabani, Rexhep Meta, Liman Peruva, Anila Pasha, Agim Misha, Qamil Nuredini, Petrit Kalla, Pëllumb Mustafaj, Muharrem Ademi

Qendra Komunitare:
Mehmet Pisha, Zyri Bedalli, Fatma Gjini, Ornela Jani, Blerta Manaj

Soros:
Aida Dushku.

TERRE DES HOMMES:
Besjana Brahaj

Vlerësime të veçanta për:
Kryetarin e Bashkisë Elbasan:
Qazim Sejdini

Drejtorinë e Koordinim-Zhvillimit:
Diamanta Vito, Dashamir Xhixha, Kristina Tavanxhiu

Kryetarin e Rajonit nr.6:
Xhevahir Budani

Dhe së fundi, shumë falënderime për median lokale të qytetit të Elbasanit që, nëpërmjet kronikash të veçanta, ka mundur të bëjë transparent dhe publik procesin.

Përmbledhje

"Programi i Zhvillimit të Zonës Pilot 'Lagjja 5 Maji', Qyteti Elbasan" i parashtruar në këtë dokument është një nga komponentët e projektit dyvjeçar "Hapa drejt një Shoqërie gjithëpërfshirëse në Elbasan, integrimi i grupeve të prekura në zhvillimin urban", financuar nga Cordaid Holandë dhe menaxhuar nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit.



Ky projekt, në mënyrë të drejtpërdrejtë, synoi realizimin e aktiviteteve të cilat ndikuan deri diku në integrimin e komunitetit të zonës pilot në zhvillimin e mëtejshëm urban të qytetit të Elbasanit, duke u krijuar banorëve të zonës mundësinë për t'u ndier qytetarë të barabartë të tij.

"Programi i Zhvillimit të Zonës Pilot 'Lagjja 5 Maji'" vjen si pjesë e hartimit të Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit në kuadrin e programit EGUG II. Kjo strategji përfshin edhe adresimin e nevojave dhe prioriteteve të minoritetit Rom, duke qenë se ky minoritet përfaqësohet me 10% të tërësisë së tij në qytetin e Elbasanit.

Në kuadër të zhvillimit kompleks të zonës pilot, Bashkia Elbasan, Rajoni nr. 6, përfaqësuesit e zonës pilot dhe Qendra Komunitare Rome me mbështetjen e Co-PLAN morën një iniciativë të re, atë të hartimit të një dokumenti bazë që do të përmbante prioritetet e zhvillimit të zonës pilot për 5 vitet e ardhshme me qëllim final zhvillimin e qëndrueshëm në nivel lokal.

"Programi i Zhvillimit të Zonës Pilot 'Lagjja 5 Maji'", përfaqëson një pjesëmarrje të gjerë komunitare të ndihmuar nga Pushteti Lokal dhe aktorë të tjerë për të krijuar një vizion bashkëkohor për zhvillimin e kushteve të jetesës së banorëve në pesë vitet e ardhshme. Ai integron çështjet e zhvillimit social, ekonomik e mjedisor në kuadrin e dialogut me bazë komunitare. "Programi i Zhvillimit të Zonës Pilot" vendos gjithashtu themelet për kalimin nga një metodë e mbyllur qeverisëse drejt një metode të hapur dhe gjithëpërfshirëse që mundëson mobilizimin e burimeve në nivel lokal.

Hartimi i programeve lokale të zhvillimit është zbatuar në shumë vende të botës në kushte dhe kohë të ndryshme. Modelet më të suksesshme kanë qenë ato të cilat janë zhvilluar paralel me ngritjen e vetëdijes së komunitetit lidhur me çfarë është zhvillimi i qëndrueshëm. Një nga eksperiencat e ngjashme të suksesshme të këtij programi është edhe rasti i Bathores në Bashkinë Kamëz, eksperiencë e para e këtij lloji në Shqipëri mundësuar nga Co-PLAN.

"Programi i Zhvillimit të Zonës Pilot 'Lagjja 5 Maji', qyteti Elbasan" është një angazhim i drejtpërdrejtë i pushtetit lokal dhe komunitetit të zonës pilot, i cili ndihmon për të balancuar zhvillimin e ardhshëm ekonomik, edukativ, kulturor dhe urban të popullsisë së zonës pilot me nevojat e saj për përfshirje drejt integrimit social-urban me qytetin e Elbasanit.

Për hartimin e dokumentit të Programit të zhvillimit të zonës pilot janë marrë në konsideratë dokumentet e mëposhtme:

Strategjia e Zhvillimit të Qytetit të Elbasanit

Studimi Social – Ekonomik për zonën pilot, 2007

Plani për zhvillimin infrastrukturor të zonës pilot

Strategjia Kombëtare Rome për Integrim.

1 Pse programi i zhvillimit të zonës pilot?

Pavarësisht nga proceset e zhvillimit social, ekonomik e urban që po kalon qyteti i Elbasanit, zona pilot ende ka mbetur një zonë e paurbanizuar e tij. Situata aktuale e zonës pilot mund të përshkruhet nëpërmjet këtyre karakteristikave:

- Pronësi informale ose e pasigurt
- Përfaqësim i dobët në qeverisjen vendore.
- Akses i pamjaftueshëm në shërbimet bazë (fizike dhe sociale) si shkollat, qendrat shëndetësore, infrastruktura, higjiena etj.
- Diskriminim në formë pasive i popullsisë rome për shkak të përkatësisë racore dhe etnike

Për këto arsye, një nga sfidat e pushtetit lokal ishte gjetja e mënyrës për të përballuar situata të tilla të



vështira dhe komplekse të krijuara nga popullimi i zonës pilot në mënyrë të çrregullt dhe informale. Në një situatë të tillë, pushteti lokal nuk kishte kapacitete për të hartuar plane zhvillimi për lagjet "problematike", ndërkohë që



"kërkesa" për përmirësimin e kushteve bazë të jetesës së banorëve të zonës pilot sa vinte dhe rritej.

Për rrjedhojë, autoritetet lokale, në bashkëpunim me komunitetin dhe me pjesëmarrjen e sektorit privat dhe të shoqërisë civile si dhe me ndihmën e donatorëve, krijuan mundësinë e zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit Elbasan në nivel lagjeje nëpërmjet hartimit të dokumentit të "Programit të zhvillimit të zonës pilot, 'Lagjja 5 Maji'". Ky dokument identifikon përparësitë e duhura për

zhvillimin e zonës pilot në dobi të komunitetit, në përputhje me objektivat e strategjisë, duke ndryshuar deri diku rolin e pushtetit lokal nga "furnizues" i drejtpërdrejtë i infrastrukturave dhe shërbimeve urbane, në "aftësues", nëpërmjet krijimit të një mekanizmi në të cilin banorët dhe grupet e komunitetit luajnë një rol gjithmonë e më të madh në plotësimin e nevojave të tyre.







2 Cilat janë avantazhet që krijon programi i zhvillimit?

"Programi i zhvillimit për zonën pilot, 'Lagjja 5 Maji', qyteti Elbasan", duke qenë një dokument bazë zhvillimi i hartuar dhe miratuar nga vetë komuniteti në bashkëpunim edhe me pushtetin lokal, ka shanset më të mëdha për t'u zbatuar.

Ky dokument do të lehtësojë punën e të gjitha institucioneve të pushtetit vendor dhe të aktorëve të tjerë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në zonën pilot si dhe do të shërbejë si një dokument orientues për këto institucione të pushtetit lokal dhe për donatorët ndërkombëtarë që mbështesin zhvillimin e kësaj popullsie në nivel lagjeje.



Dokumenti do të shërbejë në përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe sociale në zonën pilot, për të rigjallëruar kushtet e jetesës së komunitetit të kësaj zone, duke u bazuar në prioritetet e përcaktuara nga vetë komuniteti në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të



Qytetit dhe me rekomandimet e Strategjisë Kombëtare për Komunitetin Rom.

Gjithashtu, hartimi i një dokumenti të tillë është një ndërmarrje serioze që do të rrisë besueshmërinë për sa i përket thithjes së fondeve dhe do të sigurojë mbështetje jo vetëm nga ana e pushtetit lokal por edhe e atij qendror dhe jo vetëm nga sektori qeveritar por edhe nga ai privat e nga OJF të ndryshme. Angazhimi, mirëkuptimi dhe motivimi i banorëve janë elementë themelorë për të siguruar suksesin lidhur me ndërmarrjen e iniciativave të reja.

Në kuadër të dokumentit, pushteti lokal do të përcaktojë fondet përkatëse, sipas projekteve konkrete, të cilat do të shërbejnë për realizimin e përparësive të zhvillimit të zonës pilot në periudhën 2008-2013.

Gjithë procesi i hartimit të dokumentit i ka shërbyer krijimit të një fryme të re, si brenda komunitetit, për integrimin e tij me pjesën tjetër të qytetit dhe krijimin e një mentaliteti të ri, atij të zhvillimit urban bashkëkohor, ashtu edhe në marrëdhëniet me pushtetin lokal, duke e shndërruar bashkëpunimin e këtij pushteti me komunitetin në një element të domosdoshëm për një qeverisje të mirë lokale.

Programi i zhvillimit të zonës pilot do të synojë të shërbejë si një instrument për të vënë në zbatim Strategjinë Kombëtare për Romët në nivel vendor në përputhje me objektivat zhvillimorë dhe rekomandimet e dhëna në Strategjinë e Zhvillimit të Qytetit.





3 Procesi i hartimit programit të zhvillimit të zonës pilot

3.1 Qëllimi dhe objektivat

Roli në rritje i lagjeve të banuara të cilat ndikojnë në cilësinë e mjedisit jetësor të qytetit duhet parë i lidhur ngushtë me interesat e zhvillimit të qytetit si një i tërë.

"Programi i zhvillimit për zonën pilot, 'Lagjja 5 Maji'" është një instrument lokal për zbatimin e suksesshëm të Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit dhe mishëron një vizion të përbashkët zhvillimi për zonën gjatë viteve 2008-2013, të arritur bashkërisht nga banorët, autoritetet dhe aktorë të tjerë, duke vjelë propozimet dhe kontributet e vlefshme nga palët e përfshira, por edhe duke u kërkuar që të marrin rolin dhe përgjegjësinë e tyre drejt përmbushjes së këtij vizioni për të maksimizuar rezultatet e arritura.

Në ndërtimin e një programi të tillë, rol parësor i është dhënë pjesëmarrjes komunitare në procesin e planifikimit dhe realizimit të nevojave duke sjellë kështu një qasje të re dhe një mjet fuqizues për banorët e zonës pilot në artikulimin e së ardhmes së tyre dhe në zhvillimin e lagjes në mënyrë cilësore. Dëshirat, kërkesat dhe parashikimet e artikuluara nga banorët në bashkëpunim me pushtetin lokal, në funksion të përmirësimit të jetesës së tyre dhe zhvillimit të zonës, janë përkthyer në synime të prekshme dhe të realizueshme si pjesë e këtij dokumenti.

Thelbi dhe vlera e dokumentit të Programit të zhvillimit për zonën pilot qëndron në faktin se ai është modeluar për dhe me komunitetin e zonës, duke iu përshtatur nevojave të tij, zhvillimeve, problematikës specifike të popullsisë rome dhe prioriteteve madhore të zhvillimit të zonës në kuadrin e zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit të Elbasanit.

Pjesëmarrja e gjerë e personave të përfshirë në procesin e përgatitjes së dokumentit e bën këtë dokument "popullor" dhe rrit shanset për zbatimin e mëtejshëm me sukses të tij. I gjithë procesi është konceptuar si një mënyrë komunikimi dhe shkëmbimi mendimesh e plotësimi nevojash mes aktorëve të interesuar për zhvillimin e zonës pilot: pushteti lokal si ofrues i shërbimeve për qytetarët dhe orientues i zhvillimit në lagje, banorët e zonës pilot si ata të cilët krijojnë identitetin e saj dhe përfitojnë nga shërbimet e ofruara në të dhe OJF-të që punojnë në zonë me

fokus zhvillimin dhe integrimin e saj. Co-PLAN, gjatë gjithë procesit, ka qenë udhëheqës dhe orientues në funksion të krijimit të urave të qëndrueshme të bashkëpunimit mes këtyre aktorëve.

Procesi i përgatitjes së dokumentit të Programit të Zhvillimit të Zonës Pilot është shtrirë në harkun kohor të pothuaj një viti dhe është shoqëruar me veprimtari për ngritjen e kapaciteteve njerëzore në fushën e zhvillimit organizativ dhe për promovimin e një pjesëmarrjeje aktive në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e procesit të zhvillimit të kësaj zone.

Konkretisht, qëllimi kryesor i hartimit të programit të zhvillimit të zonës pilot është i lidhur me arritjen e konsensusit për zhvillimin e kësaj zone në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të qytetit nëpërmjet një procesi konsultimesh midis qeverisjes lokale dhe të gjitha grupeve të komunitetit dhe aktorëve të tjerë duke sjellë një ndikim pozitiv në gjendjen sociale dhe ekonomike të popullsisë që jeton në këtë zonë.



Ky proces krijoi mundësinë e ndërtimit të partneriteteve midis grupeve të ndryshme të komunitetit për të zgjidhur çështje të rëndësishme dhe për t'u siguruar që të gjitha vendimet dhe veprimet që do të ndërmerreshin në fusha të ndryshme nuk do të vinin në rrezik të ardhmen e lagjes dhe qytetit. Procesi i përfshirjes së komunitetit rom u bazua në vullnetin e komunitetit dhe në të parët e kësaj përfshirjeje si përgjegjësi e qeverisjes lokale.

Në programin e zhvillimit të zonës pilot gërshetohen tre objektiva kryesorë si më poshtë:

Objektivi 1: *Nxitja e zhvillimit ekonomik, social dhe fizik të zonës pilot.*

Programi i zhvillimit të zonës pilot në përgjithësi do të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm të të gjitha llojeve të aktiviteteve e shërbimeve të cilat janë identifikuar si përparësi të zhvillimit të kësaj zone. Kjo përfshin pushtetin lokal, institucionet shtetërore të shërbimeve, donatorët, organizatat jofitimprurëse dhe të gjithë aktorët e tjerë që marrin pjesë në procesin e zhvillimit të zonës.

Objektivi 2: Ky është një objektiv i ndërthurur që lidhet me Zhvillimin e partneritetit dhe bashkëpunimit afatgjatë ndërmjet banorëve të zonës pilot, pushtetit lokal, institucioneve, në mënyrë të veçantë shërbimeve dhe shkollave, organizatave të shoqërisë civile, OJF-ve, organizatave profesioniste, OBK-ve etj. duke rritur intensitetin e këtij bashkëpunimi dhe duke inkurajuar vendosjen e partneriteteve afatgjata si një nga problemet kryesore gjatë gjithë periudhës së hartimit të dokumentit dhe zbatimit të tij.

Ky objektiv do të arrihet nëpërmjet zbatimit të skemave të granteve dhe donacioneve për aktivitete të tipit njerëzit-për-njerëzit, projekteve që kanë një dimension kulturor dhe social si dhe projekteve të tipit ekonomik/tregtar të cilat nxisin rritjen ekonomike dhe zhvillimin social të komunitetit (organizimi i panaireve, studimet e tregut etj.)

Objektivi 3: Përdorimi i dokumentit të programit të zhvillimit të zonës zyrtarisht nga Bashkia Elbasan duke marrë miratimin e Këshillin Bashkiak.

Ky objektiv synon mbështetjen dhe fuqizimin e eksperiencës së krijuar dhe tendencës

ekzistuese për zgjidhjen e problemeve të zonës në nivele të ndryshme nga ana e aktorëve përgjegjës duke marrë legjitimitetin e dokumentit në institucionet shtetërore përgjegjëse për aprovimin, zbatimin dhe monitorimin e tij. Kështu, pushteti lokal duhet të përcaktojë qartë përgjegjësitë lokale dhe mënyrën e realizimit të planeve të veprimit në përputhje me dokumentet strategjike të zhvillimit të qytetit.

3.2 Përfshirja në nivelin politik dhe komunitar e aktorëve të interesuar

Ç'ndikim ka komuniteti në zhvillimin e lagjes së tij?



Përfshirja e banorëve dhe e sektorit privat si partnerë të pushtetit lokal në zhvillimin e lagjeve të banimit ka filluar tashmë në Shqipëri. Aktualisht, kultura e pjesëmarrjes së komunitetit ka ardhur duke u rritur në mënyrë progresive me rritjen e vetëdijes së anëtarëve të komunitetit për vendime që u përkasin atyre dhe që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e tyre.

Përfshirja e komunitetit është proces shumë i rëndësishëm për zbatimin e çdo projekti që synon integrimin dhe qëndrueshmërinë sociale e urbane të një zone. Të gjitha proceset zhvillohen e realizohen më mirë nëse anëtarët e komunitetit janë pjesë e konceptimit, ndërtimit, aplikimit dhe mbikëqyrjes së tyre.

Shkalla e përfshirjes së komunitetit të zonës pilot ka ndjekur etapa të ndryshme. Disa nga mënyrat e përdorura për të siguruar pjesëmarrjen sa më të gjerë të komunitetit gjatë procesit të hartimit të programit të zhvillimit të zonës pilot konsistojnë në:

- Ngritjen dhe asistimin e Organizatës me Bazë Komunitare, "Romano Sezi" duke i konsideruar

përfaqësuesit e kësaj organizate si një kanal komunikimi midis banorëve të zonës pilot dhe përfaqësuesve të pushtetit lokal.

- Organizimin e konsultave për nxitjen e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të komunitetit me qëllim identifikimin e prioriteteve të zonës pilot.
- Realizimin e hapave për përfshirjen



e anëtarëve të komunitetit në projekte konkrete që në momentin e identifikimit dhe votimit të prioriteteve e deri në kontributin në infrastrukturë (procesi i investimeve fizike).

Përfaqësimi i të gjitha grupeve të interesuara të komunitetit, rom dhe jo rom, ishte themelor për të pasur një aktivizim sa më të madh të këtij komuniteti dhe për të arritur konsensusin e gjithë grupeve të tij me përkatësi racore të ndryshme (Zona pilot kategorizohet si "zonë rome").

Pikërisht kjo ishte pika fillestare për të mundësuar programin e zhvillimit të zonës pilot ku të gjithë nivelet e komunitetit kanë përfaqësinë e duhur.

Kjo nënkupton që pjesëmarrës nuk ishin vetëm përfaqësuesit e zgjedhur të komunitetit rom por edhe përfaqësues nga organizatat me bazë komunitare, shoqatat joqeveritare që veprojnë në këtë zonë, grupet që përfaqësojnë interesat e biznesit që ushtron veprimtarinë e tij në këtë zonë, të rinjtë dhe më të moshuarit, të papunët etj..

Ç'ndikim (ç'rol) ka pushteti lokal në



programin e zhvillimit të zonës pilot?

Procesi i decentralizimit i krijoi Bashkisë Elbasan mundësinë për të ofruar shërbime sipas një modeli të ri zhvillimi për zonën pilot.

Bashkia e Elbasanit është një nga bashkitë e vlerësuara pozitivisht nga raporti i vlerësimit mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Romët i prezantuar nga fondacioni Soros. Bashkia Elbasan me punën e saj ka mbështetur minoritetin Rom në zhvillimin e mëtejshëm për përmirësimin e kushteve të jetesës. Në kuadër të këtij procesi, pushteti lokal ka kryer investime sociale dhe fizike. E veçanta e investimeve sociale në zonën pilot është mbështetja e një Qendre

Komunitare Rome nga bashkia, në bashkëpunim me fondacionin Soros, e cila padyshim është një iniciativë shumë e mirë që ka sjellë rezultate pozitive të dukshme në jetën e komunitetit të zonës pilot dhe në ofrimin e shërbimeve sociale si edhe një ndihmesë ndaj grave, fëmijëve e të rinjve.

Në lidhje me investimet fizike, pushteti lokal është bërë bashkëfinancues me Co-PLAN në realizimin e projektit "Hapa drejt një Shoqërie gjithëpërfshirëse në Elbasan, integrimi i grupeve të prekura në zhvillimin urban", projekt i cili, përveç zhvillimit social të popullsisë, përfshin dhe realizimin e investimeve fizike për zonën pilot.

Konkretisht investimet fizike në zonën pilot përfshijnë:

- Stabilizimin e përroit të Camurrit
- Përmirësimin e pjesshëm të kanalizimeve të ujërave të zeza për një pjesë të zonës pilot
- Përmirësimin e rrugës në krahun jugor të përroit të Camurrit
- Vendosjen e 20 kazanëve për mbeturinat.
- Ndriçimin rrugor për të gjithë zonën pilot



Investimet fizike të mësipërme u përcaktuan si prioritete nga komuniteti i zonës pilot nëpërmjet aplikimit të procesit të buxhetimit me pjesëmarrje i cili u zhvillua nga Bashkia Elbasan dhe nga studimi social-ekonomik që u krye nga Co-PLAN.

Ndërsa, në kuadrin e Programit të zhvillimit të zonës pilot, bashkia ndërmori rolin e orientuesit duke aplikuar një vizion strategjik dhe një mënyrë strategjike të menduari në udhëheqjen e një procesi zhvillimi në dobi të të gjithë banorëve pa dallim përkatësie racore. Ky proces u realizua me metodat e reja të planifikimit dhe zhvillimit duke krijuar mundësinë e arritjes së objektivave të Strategjisë së zhvillimit të Qytetit në nivel lagjeje.

Përgjatë gjithë proceseve të zhvillimit të zonës pilot, autoritetet lokale kanë luajtur një rol të domosdoshëm në mobilizimin dhe menaxhimin e burimeve për të krijuar mundësinë që zona pilot të ketë parametra optimalë banimi.

Në çdo rast, me aplikimin e Programit të Zhvillimit të zonës pilot, zgjidhja e problemeve urbane, sociale dhe ekonomike tashmë nuk i përket vetëm një institucioni, por buron nga bashkëpunimi i shumë aktorëve. Aplikimi i metodave të reja të bashkëpunimit për një zhvillim të qëndrueshëm lokal ose rajonal përbën një nga sfidat vendimtare për autoritetet lokale, jo vetëm në nivel zone por për të gjithë qytetin.

3.3 Zgjedhja e Strategjisë

Grupi i punës

Në kuadër të procesit të hartimit të Programit të Zhvillimit të Zonës Pilot, përfaqësuesit e komunitetit dhe autoritetet lokale organizuan grupet e punës të cilat diskutuan përparësitë e zhvillimit të kësaj zone. Këto grupe pune përfshinë specialistë teknikë, përfaqësues nga seksione të bashkisë, anëtarë të zakonshëm të komunitetit të cilët kanë interesa apo njohuri në një fushë të caktuar dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm në jetën e zonës pilot.

Grupet e punës ishin shtylla kurrizore në procesin e formulimit të modelit të integrimit të komunitetit rom duke vepruar si përfaqësues për mbledhjen dhe vlerësimin e informacionit të duhur si dhe për formulimin e veprimeve të mundshme për zgjidhjen e problemeve kryesore të mbarë komunitetit. Reflektimi nga ana e tyre i interesave të komunitetit ishte faktor vendimtar për arritjen e konsensusit lidhur me propozimet që u bënë. Motivimi dhe angazhimi i grupeve të punës në formulimin e problemeve kryesore të komunitetit dhe reflektimin e ideve të tij çoi në krijimin e një mënyre të re të menduari dhe të vepruari në nivel lagjeje.

Ky imazh që grupet e punës krijuan për zonën pilot duke formuar plane konkrete të cilat mund të japin rezultate pozitive në perspektivën afatgjatë, iu përcoll edhe publikut më të gjerë për të parë nëse ky model, i cili paraqet jetën e kësaj zone, është i pranueshëm prej tij.

Konsultimi

Për të pasur një proces gjithëpërfshirës, në të gjitha fazat e hartimit të Programit të zhvillimit u organizuan konsultime në nivel zone. Për këtë qëllim u mbajtën tri mbledhje në pjesë të ndryshme të zonës duke ftuar në mënyrë të hapur banorët sipas fiseve rome me problematika të ndryshme, organizatat me bazë komunitare, OJF të ndryshme etj.. Pjesëmarrësve iu paraqitën qëllimi dhe objektivat e modelit të integrimit dhe një vështrim i përgjithshëm i planeve të veprimit të zhvilluara dhe i arritjeve të deriatëhershme.

Gjatë takimeve, pjesëmarrësve iu dha mundësia që të komentonin mbi planet e veprimit në dy mënyra: nëpërmjet diskutimeve të zhvilluara, prej nga u mblodh informacioni mbi opinionet e tyre, dhe nëpërmjet një



"flete votimi" ku ata shënuan se cilat prej këtyre ideve dhe përparësive do të përfshiheshin si pjesë e modelit të integrimit të zonës rome.

Kjo krijoi mundësinë që një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish të paraqisnin shqetësimet e tyre duke nxjerrë në pah komente të përgjithshme mbi procesin dhe rezultatet të cilat përfshinin nevojën për një pjesëmarrje më të gjerë të pushtetit lokal, pjesëmarrjen e të gjitha ngjyrave politike dhe pjesëmarrjen më të gjerë të popullsisë jo rome që jeton në lagjen e përzgjedhur. Gjithashtu ato përfshinin nevojën për vetëdije dhe besim më të lartë të komunitetit lidhur me realizimin e projekteve, nevojën për të adresuar problemin kryesor të integrimit me qytetin, nevojën për pjesëmarrjen e grave dhe nevojën për të realizuar projekte të vogla në kohë të shkurtër të kombinuar me projekte afatgjata. Të gjitha komentet e marra nga grupi i konsultimit u reflektuan gjatë procesit në vazhdim.

Forumi në Zonën Pilot

Në fund të procesit të hartimit të dokumentit u organizua nga Pushteti Lokal një forum përfundimtar në shkallë zone pilot ku u ftuan të gjithë pjesëmarrësit në proces, banorë të rajonit nr. 6, përfaqësues të bashkisë, përfaqësues të rajonit, përfaqësues të Këshillit Bashkiak, përfaqësues të bizneseve që zhvillojnë aktivitet në zonë, OJF etj..



Përfaqësuesit e grupeve të punës paraqitën një përmbledhje të situatës social-ekonomike dhe infrastrukturore të lagjes, një vështrim të përgjithshëm mbi përparësitë dhe rezultatet e planeve të veprimit të detajuara. Gjithashtu u kërkua në parim mundësia e aprovimit të dokumentit në Këshillin Bashkiak dhe përfshirja e tij në planet afatgjata të Bashkisë për zhvillimin e qytetit.

Gjatë forumit pjesëmarrësit u ftuan të shikonin dhe lexonin të gjitha planet e veprimit dhe të jepnin komentet e tyre me shkrim në fletët e varura në mur posaçërisht për këtë qëllim. Së fundi, pjesëmarrësve iu kërkua që të votonin për 18 planet e veprimit të paraqitura duke renditur sipas shkallës së përparësisë tre me kryesorët dhe duke treguar midis tyre prioritetin numër një.

3.4 Përparësitë e zhvillimit

Bazuar në analizën e hollësishme të gjendjes së zonës pilot në këndvështrimin e Strategjisë Kombëtare për Integrimin e Romëve dhe Strategjisë së Zhvillimit

të Qytetit të Elbasanit, grupeve të punës iu kërkua të zhvillonin seanca të rrahjes së mendimeve dhe të përzgjidhnin shqetësimet e idetë e tyre të cilat ata mendonin se duhet të përfshiheshin si pjesë e programit të zhvillimit të kësaj zone.

Gjatë këtyre seancave dolën shumë ide, gjë që tregoi natyrën e shumëfishtë të këtyre problemeve parësore në zonën pilot. Megjithatë, u përcaktuan katër synime strategjike parësore për këtë zonë. Për secilin synim janë përcaktuar treguesit përkatës, duke marrë si bazë vlerën e sotme të tyre dhe duke parashikuar vlerën për periudhat e ardhshme, derinëvitin 2013. Gjithashtu, për secilin synim janë përzgjedhur programet parësore, zbatimi i të cilëve ndikon drejtpërdrejt në arritjen e synimit. Këto programe janë detajuar më tej në projekte orientuese dhe, për secilin projekt, është parashikuar koha e nevojshme për zbatimin e hapave të procesit, partnerët e mundshëm, identifikimi dhe përfshirja e të gjithë aktorëve, kostoja e përafërt, që mund të jetë investim i drejtpërdrejtë ose kosto e asistencës për kryerjen e procesit, dhe financuesi kryesor i mundshëm.

Për të drejtuar dhe lehtësuar këtë proces u përdorën formate të gatshme të cilat bazoheshin në një qasje hap-pas-hapi për zgjidhjen e problemeve në mënyrë të qëndrueshme. Për zonën pilot janë përzgjedhur si më parësorë 18 projekte.

Përparësitë që u përzgjodhën kanë të bëjnë me përshpejtimin e ritmeve të zhvillimit ekonomik, social dhe infrastrukturor, shtimin e mundësive për edukim, përkujdesjen më të madhe për shëndetin, barazinë gjinore, përfshirjen sociale, strehimin dhe mjedisin si çështjet më kryesore që mund të ndikojnë në përmirësimin e shpejtë të kushteve të jetesës së banorëve të zonës pilot.


Duke marrë parasysh rëndësinë e përmirësimit dhe forcimit të mëtejshëm të përfaqësimit të komunitetit rom në qeverisjen lokale, këtyre objektivave iu shtua edhe qeverisja e mirë. Në këtë përzgjedhje u përfshinë përfaqësues të institucioneve shtetërore si Bashkia apo Këshilli Bashkiak të cilët, sipas problematikës së përzgjedhur, morën pjesë drejtpërdrejt në analizat e veçanta dhe në diskutimet për përcaktimin e përparësive të zhvillimit që lidhen me përfshirjen sa më të mirë të komunitetit rom në nivelet e vendimmarrjes lokale.

Çdo grupi pune iu kërkua më pas të rendiste idetë sipas shkallës së përparësisë dhe të zhvillonte plane veprimi për secilën prej ideve që këto grupe mendonin se duheshin zhvilluar më tej për zbatim në zonën pilot. Për të drejtuar dhe lehtësuar këtë proces u përdorën formate të gatshme të cilat bazoheshin në një përqasje hap-pas-hapi për zgjidhjen e problemeve në mënyrë të qëndrueshme. Këto formate përfshinin identifikimin dhe angazhimin e të gjithë aktorëve, mundësinë për gjetjen e fondeve dhe skedën kohore për zbatimin e hapave të procesit. Gjatë procesit të hartimit të planeve të veprimit, një kohë e konsiderueshme iu dedikua diskutimit mbi mundësinë e gjetjes së fondeve dhe mbi faktin se qëllimi kryesor i procesit të hartimit të Programit të Zhvillimit të Zonës Pilot ishte të krijonte plane veprimi për zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj zone dhe të qytetit të Elbasanit mbi bazën e një procesi konsultimi dhe konsensusi me shtrirje të gjerë.

3.5 Ngritja e vetëdijes

Gjatë procesit të hartimit të Programit të zhvillimit të zonës pilot me komunitetin rom u përdor një strategji e veçantë komunikimi për ngritjen e vetëdijes së aktorëve pjesëmarrës dhe të komunitetit rom në tërësi, me synim transparencën dhe publikimin e procesit dhe bashkëpunimin ndërmjet palëve të interesuara. Gjatë këtij procesi u kontaktuan një sërë biznesmenësh lokalë, mësuesish, nxënësish nga shkolla e mesme, OJF lokale që punojnë me çështjen e romëve, organizata me bazë komunitare si edhe individë. Gjithashtu, për të parë prioritetet dhe shqetësimet e tyre, u qarkullua një pyetësor i hartuar për këtë qëllim. Të dhënat e marra nga pyetësori për prioritetet jepen në grafikun më poshtë.

Grafiku. Prioritetet sipas banorëve të zonës pilot





Ky pyetësor u përdor për të mbledhur informacionin bazë mbi gjendjen ekzistuese të zonës pilot dhe zhvillimet e saj duke u fokusuar në mënyrë të veçantë tek popullsia, baza ekonomike, punësimi, edukimi, strehimi, të drejtat, zhvillimi urban, transporti, ujërat, kanalizimet, furnizimi me energji elektrike etj..

Në funksion të kësaj ideje janë shpërndarë publikime në media dhe fletushka informative dhe janë organizuar takime e trajnime me banorët si dhe programe televizive.














4 Profili i zonës pilot

4.1 Karakteristikat Fizike

Zona pilot në qytetin e Elbasanit është ndërtuar në vitin 1946. Ajo ndodhet në pjesën lindore të qytetit. Shtrihet në fushën e Elbasanit, në krahun e djathtë të rrjedhës së mesme të lumit Shkumbin, e rrethuar në lindje nga Krasta e Madhe dhe e Vogël, në veri dhe veriperëndim nga kodrat e Ullishtave, në perëndim nga përroi i Zaranikës dhe në jug nga lumi Shkumbin. Në anën perëndimore të qytetit kalon përroi i Zaranikës dhe nga lindja ai i Manazderies.

Kjo zonë shtrihet në territorin e Komunës së Labinotit, jashtë kufirit administrativ të qytetit të Elbasanit,





dhe kufizon Lagjen 5 maj me lagjet e komunës, ndërsa popullsia e kësaj zone është e regjistruar në Rajonin Nr. 6 të Bashkisë Elbasan.

Pjesa e zonës pilot e populluar nga komuniteti rom ndodhet brenda një unaze të vogël. Kjo unazë mund të quhet

edhe një kufi natyror midis pjesës së lagjes që banohet nga popullsi rome dhe pjesës tjetër që banohet nga popullsi jo rome.

Kjo zonë është tepër e rëndësishme sepse lidh zonën bujqësore me atë ekonomike në periferi të qytetit të Elbasanit.

Tendenca e lëvizjeve demografike: rreth 1% rritje në vit.

Zhvillimi perspektiv i zonës: Zonë banimi me intensitet të ulët ndërtimesh. Ndërtimet do të jenë deri në 2-3 kate të larta.

Të dhëna sizmogjeologjike: Zona ndodhet në prerjen tërthore Elbasan-Dibër me magnitudë të pritshme deri në 8 ballë (siç paraqitet në hartën rajonale sizmike). Theksojmë se zona përfshihet në zonën ujëmbajtëse të qytetit të Elbasanit dhe në dy vende përshkohet nga një përrua dhe një kanal i ujërave të larta të zonës.

4.2 Karakteristikat e popullsisë

Zona pilot ka karakteristikat e një zone me popullsi heterogjene. Numri i popullsisë së zonës pilot është afërsisht 2.500 banorë (e dhënë e marrë nga Plani Rregullues i Qytetit të Elbasanit) dhe numri i familjeve rreth 300, prej të cilave rreth 250 janë familje rome. Në qytetin e Elbasanit jeton një popullsi e madhe rome; sipas statistikave të Bashkisë Elbasan, rreth 10% të popullsisë së qytetit (afërsisht 11.300 banorë) e përbën popullsia rome.

Gjatë viteve '90, zona pilot, e cila deri në atë kohë ishte e banuar vetëm nga popullsi rome, pati një fluks të madh të të ardhurve nga zonat rurale të qytetit të Elbasanit, Librazhdit, Korçës etj.. Aktualisht, në kohën e sotme, kjo zonë ka një përbërje etnike të shumëllojshme. Në pjesën qendrore të saj është vendosur pjesa më e madhe e popullsisë rome, ndërsa në pjesën periferike janë vendosur banorët që kanë ardhur në zonë gjatë viteve '90. Fakti që zona pilot është një zonë tepër heterogjene për shkak se banohet nga një popullsi rome dhe jo rome, përbën një potencial shumë të rëndësishëm për integrimin e komunitetit rom në këtë zonë.

Dihet që në përgjithësi popullsia rome është një popullsi që lëviz nga një vend në tjetrin për shkak të kulturës dhe traditës. Popullsia rome në zonën pilot ka një karakteristikë të veçantë nga të gjithë romët e vendosur në Shqipëri: banorët romë të kësaj zone nuk e ndryshojnë shpesh vendbanimin e tyre.

4.3 Zhvillimi ekonomik

Gjendja sociale dhe ekonomike e zonës pilot paraqitet shumë kritike. Shkalla e varfërisë dhe papunësisë është shumë e lartë. Papunësia është



në shifra alarmante: deri në 50% (e dhënë e marrë nga qendra komunitare rome). Kjo shifër tregon për një shkallë të lartë të varfërisë e cila është e lidhur me nivelin e ulët arsimor, me jetesën në shtëpi të vogla nën standard, me mungesën e ushqimit bazë, me vështirësitë në plotësimin e nevojave minimale për jetesë etj.. Rreth 50% e familjeve janë me asistencë sociale (e dhënë e marrë nga qendra rome) dhe pa të ardhura të tjera që do të thotë që ndihma ekonomike është e vetmja e ardhur mujore dhe se të gjitha këto familje janë në varfëri ekstreme.

Rreth 65% e familjeve nuk kanë asnjë anëtar të punësuar, 14% e familjeve kanë anëtarë të punësuar përkohësisht dhe 20% e familjeve kanë anëtarë të punësuar në punë fikse (të dhëna të marra nga studimi social-ekonomik i kryer nga CO-PLAN).

Të gjithë banorët romë të zonës pilot që kanë një punë, janë të punësuar në mënyrë informale dhe nuk ka asnjë që të jetë punësuar në punë formale. Pra, realisht, burimi kryesor i të ardhurave është puna private informale e cila kryesisht përqendrohet në sektorin e tregtisë, shitjet ambulante, ndërtim, mbledhje hekuri për skrap, mbledhje kanoçesh etj.. Të ardhurat mesatare mujore për familje janë 141$ dhe variojnë nga 0$ deri në 390$. Vlera 0$ ka të bëjë më mendësinë e të këtij komuniteti i cili konsideron si të ardhura vetëm ato që vijnë nga një punë e përhershme fikse dhe nuk i konsideron si të tilla të ardhurat e ulëta që siguron me forma të ndryshme.

Grafiku paraqet në mënyrë të detajuar përqindjet e shpërndarjes së të ardhurave




Përqindja dërrmuese e të ardhurave mujore të popullsisë rome të zonës pilot harxhohet për ushqime (mbi 90%) dhe vetëm 10% e këtyre të ardhurave shpenzohet për veshmbathje, pagesa faturash etj..

Në zonën pilot, jo vetëm për popullsinë rome, mbizotëron puna e paspecializuar e cila shoqërohet me të ardhura të ulëta. Diferencat e llojit të punësimit influencojnë mbi nivelin e të ardhurave të kësaj zone.

Për romët e zonës pilot asistenca sociale, puna e fëmijëve dhe të ardhurat e punësimit joligjor ose të vetëpunësimit zënë një vend të rëndësishëm në të ardhurat e familjes.

me synim përmirësimin e gjendjes ekonomike e sociale në të ardhmen.

Grafiku. Arsyet e mosfrekuentimit të shkollës (frekuencat)



Grafiku 3

Siç shihet, arsyeja kryesore është braktisja e shkollës dhe mungesa e dëshirës për t'u arsimuar. Por, një supozim mund të jetë që këto arsye janë rrjedhoja të arsyeve të renditura më poshtë siç janë mungesa e të ardhurave, problemi i gjuhës, punësimi i hershëm i fëmijëve, martesa në moshë të hershme e vajzave etj.. Në thelb, këto arsye kanë faktorin ekonomik të varfërisë i cili pasqyrohet në këto veprime të cilat çojnë në braktisjen e shkollës apo mungesën e dëshirës për ta vazhduar atë.

Pavarësisht se institucionet arsimore ku përfshihen shkollat dhe qendrat profesionale janë të hapura për këdo, vërehet një frekuentim i rrallë nga romët. Kjo mund të ketë si shkak diskriminimin pasiv që bëhet ndaj kësaj pjese të popullsisë ose faktin që kultura e tyre nuk përfshin vizita të vazhdueshme në këto institucione.

4.4 Edukimi

Arsimi apo edukimi është në vetvete një e drejtë themelore e njeriut si mjet për të realizuar të drejtat e tjera. Në praktikë, ekzistojnë barriera politike, ekonomike, ideologjike e kulturore që i pengojnë shumë fëmijë të gëzojnë të drejtën për arsim. Pjesëtarë të këtij grupi janë edhe fëmijët e komunitetit rom. Nga të dhënat e marra nga Bashkia Elbasan dhe Qendra Komunitare Rome, rezulton se niveli i arsimimit të këtyre banorëve është shumë i ulët: mbi 80% e popullsisë nuk kanë shkollën e mesme, ndërsa rreth 50% janë pa shkollë fillore. Kjo përbën një problem serioz dhe bën të domosdoshëm përmirësimin e gjendjes arsimore

Përpjekjet për të kërkuar të drejta për arsimim në kushte të barabarta me shumicën e fëmijëve të tjerë në qytetin e Elbasanit nuk gjejnë gjithmonë mbështetje pasi fëmijët romë, të cilët



janë të një moshe më të madhe se fëmijët e klasave të para apo të dyta dhe nuk dinë shkrim e lexim sepse një pjesë e tyre njohin vetëm gjuhën rome, nuk mund t'i atashohen grupit të fëmijëve të këtyre klasave.

Megjithatë, në zonën pilot funksionon një Qendër Komunitare Rome e cila ofron shërbim për rreth 40 të rinj dhe fëmijë romë çdo vit. Shërbimet që ofrohen janë kurse për fëmijët në gjuhën shqipe dhe në gjuhën rome. Ky shërbim u ofrohet të gjithë fëmijëve romë të cilët nuk e dinë gjuhën shqipe dhe përgatiten për të hyrë në klasat e para. Gjithashtu, në qendër ofrohen edhe aktivitete të tjera sociale për fëmijët dhe të rinjtë romë. Qendra komunitare financohet nga Bashkia Elbasan dhe OJF si SOROS e Terre Des Hommes.

Nga të dhënat e marra nga Qendra Komunitare Rome dhe shoqata e komunitetit rom "Romano Sezi" mbi fëmijët romë në zonën pilot, rezulton se këta fëmijë ndjekin arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar në katër shkolla: Sul Domi, Qemal Haxhihasani, Hamit Mullisi dhe Xhafer Kungoi. Shoqata komunitare rome "Romano Sezi" në bashkëpunim me Qendrën Komunitare Rome ka bërë të mundur regjistrimin e 115 nxënësve nga zona pilot për vitin 2008 në shkollat e mësipërme nga klasa e parë deri në klasën e tetë.

4.5 Pronësia e tokës, strehimi, legalizimi

Banorët e zonës pilot nuk janë pronarë të ndërtesave apo të tokës që ata përdorin; toka dhe banesat e tyre janë aktualisht ilegale. Megjithatë, zona pilot është përfshirë në procesin e legalizimit të ndërtimeve informale në Shqipëri.

Zhvillimi i zonës pilot e cila banohet nga popullsia rome në qytetin e Elbasanit ka ndjekur një formë specifike. Rreth 30% e kësaj zone është ndërtuar në bazë të planifikimit të sistemit komunist për ndërtimin e lagjeve me popullsi rome.

Shtimi natyral i kësaj popullsie bëri që një pjesë e mirë e banorëve "të rinj" romë të ndërtonin shtëpi pranë familjeve të tyre duke përvetësuar token publike në mënyrë të jashtëligjshme nëpërmjet prerjes së drurëve frutorë.

Ndërsa pas vitit 1990 toka fillimisht u zaptua nga të ardhurit të cilët mbërrinin nga zonat rurale të Elbasanit, Librazhdit etj.. Banorët e ardhur morën nën zotërimin e tyre sipërfaqe të mëdha toke, rreth 300-400m² për familje (e dhënë nga Bashkia Elbasan). Toka që u zotërua nga të ardhurit ishte pa dokument zyrtar pronësie sepse para kësaj periudhe ishte tokë shtetërore dhe një pjesë e saj ishte privatizuar në vitin 1991, sipas ligjit nr. 7501, nga punëtorët e fermës dhe iu ishte shitur të ardhurve të cilët filluan të blinin tokat për ndërtim në zonën pilot.


Strehimi

Zona pilot ka kaluar pjesërisht fazat e një modeli të paplanifikuar zhvillimi. Kjo zonë ka ekzistuar si pjesë e qytetit të urbanizuar qysh nga vitet '60, me funksion strehimin e përkohshëm të popullsisë rome. Më vonë, në vitet '80, struktura e ndërtimit mbeti e njëjtë, por objektet e kësaj zone filluan të shtoheshin në numër duke pasur si funksion banimin familjar po për popullsinë rome.

Nëpërmjet vetëmenaxhimit dhe vetëndërtimit është zhvilluar procesi i përmirësimit gradual të strehimit në zonën pilot. Banorët e kësaj zone përgjithësisht i kanë ndërtuar vetë shtëpitë e tyre, si ata para edhe ata pas vitit 1990. Megjithatë, shpenzimet janë bërë kryesisht për rehabilitimin e shtëpive të vjetra dhe më pak për ndërtimin e shtëpive të reja. Një pjesë e madhe e familjeve rome që jetojnë në zonën pilot marrin hua për riparimin apo ndërtimin e shtëpive.

Ndërtimet në zonën pilot janë njëkatëshe ose dykatëshe, me dy deri në tri dhoma. Ndërtesat dykatëshe përbëjnë rreth 30% të banesave në zonën pilot dhe banohen kryesisht nga popullsia jo rome. Pjesa dërrmuese e tyre është ndërtuar gjatë viteve 1990. Një pjesë tjetër e banesave (rreth 60%) në të cilat jeton kryesisht popullsia rome janë në një gjendje jo të mirë për banim. Rreth 50% e këtyre familjeve rome jetojnë në kushte krejtësisht të papërshtatshme (e dhënë e marrë nga studimi social-ekonomik), në shtëpi të rrënuara/të parehabilituara ose në baraka, ndërsa pjesa tjetër jeton në shtëpi të vjetra por të rehabilituara.

Grafiku. Lloji i banesës në të cilën jeton popullsia rome në zonën pilot (përqindjet)



Grafiku 4

Kërkesa më e madhe për strehim ka ardhur si rezultat i lëvizjes së popullsisë dhe i të ardhurve nga zonat rurale. Të dhënat e tregut tregojnë nivele relativisht të larta të ofertës për banesa të reja. Gjithashtu edhe ndërtimi i banesave nga vetë familjarët për të plotësuar nevojat e strehimit është relativisht i lartë. Llogaritjet e kryera nga grupi i urbanistikës tregojnë se vlera e tregut për shitblerjen e një shtëpie lëkundet midis 100-150 $/m² (për zonën pilot).

Shpenzimet për të ndërtuar/rehabilituar banesat janë modeste dhe variojnë nga 0$ (në rastet kur janë futur në një banesë dhe e kanë përdorur ashtu siç e kanë gjetur) deri në 33.000$. Limiti më i lartë është vënë re vetëm tek 2 apo 3 familje, ndërsa mesatarja e shpenzuar për banesë është afërsisht 520$.

Familjet rome nuk furnizohen me ujë brenda shtëpive dhe tualetet janë të vendosura kryesisht jashtë shtëpive. Kushtet e banimit lidhen ngushtë me varfërinë dhe me të tjerë tregues negativë si mungesa e plotë e pajisjeve elektroshtëpiake që dëshmon për varfërinë ekstreme në të cilën jetojnë familjet rome.

Investimet më të mëdha në zonën pilot janë bërë kryesisht në sektorin e ndërtimit. Këto përbëjnë rreth 85% të investimeve në zonën pilot (e dhënë e marrë nga qendra komunitare). Shumë nga ndërtimet janë kryer nga vetë banorët pa iu nënshtruar procedurave përkatëse të lejeve të ndërtimit.

Disa nga arsyet kryesore të ndërtimit në vendbanime të paligjshme në zonën pilot të qytetit të Elbasanit janë:

- Mungesa e kontrollit dhe administrimit mbi tokën nga ana e pushtetit lokal (e dhënë e marrë nga shoqata komunitare "Romano Sezi").
- Fakti që zona pilot gjendet shumë pranë qendrës së qytetit të Elbasanit.
- Çmimi i ulët i tokës ose zënia pa pagesë e saj.


Legalizimi

Teknikisht, të gjitha këto familje janë "zhvillues ilegalë" sepse janë në kundërshtim me rregulloret, planin, ndërtimin dhe zonimin formal të zhvillimit të zonës në të cilën ata janë vendosur.

Duke iu referuar ligjit shqiptar, realizimi i procesit të legalizimit për të gjitha zonat informale në Shqipëri përfshiu edhe zonën pilot në qytetin e Elbasanit. Pas matjeve topografike për çdo shtëpi, banorët plotësuan formularin e vetëdeklarimit. Ky formular është plotësuar afërsisht në masën 77% (e dhënë e marrë nga agjencia e legalizimit). Kjo shifër tregon për mentalitetin e banorëve romë të zonës pilot të cilët dëshirojnë një qëndrim afatgjatë në këtë zonë. Pavarësisht se procesi i legalizimit është i gjatë dhe i komplikuar, banorët shprehen

entuziastë për faktin që brenda disa muajve do të mund të posedojnë tapitë e banesave të tyre. Duke iu referuar studimit social-ekonomik, banorët romë që jetojnë në zonën pilot kanë një tendencë qëndrimi në këtë zonë në krahasim me romët e tjerë në Shqipëri të cilët nga natyra janë një popullsi nomade. Ky argument vërtetohet me faktin se banorët romë në zonën pilot, sipas statistikave, do të vazhdojnë të përdorin për banim shtëpinë e tyre edhe në të ardhmen. Një pjesë më e vogël mendojnë ta përdorin për biznes dhe vetëm 1/10 e tyre mendojnë ta shesin si pronë për t'u vendosur diku tjetër.

Grafiku. Planet për banesën e legalizuar (në përqindje)



Grafiku 5

4.6 Infrastruktura fizike në zonën pilot

Siç dihet, qytetet e mëdha kanë mundësi zhvillimi, por rritja e menjëhershme e numrit të banorëve e ka bërë shumë të vështirë shfrytëzimin e burimeve nga të gjithë. Kjo bën që më të prekurit në këtë drejtim të jenë banorët e qyteteve të cilët jetojnë në zona informale, duke e vështirësuar integrimin e tyre në jetën social-ekonomike dhe duke i vënë ata përballë një sërë problemesh të cilat lidhen sidomos me infrastrukturën fizike si mungesa e rrugëve, e kanalizimeve, e ujit dhe e dritave të cilat janë primare për të pasur një jetë normale.

Infrastruktura rrugore

Zona pilot ka rreth 6km rrugë kryesore dhe rreth 3.5km rrugë të brendshme. Akset rrugore kryesore të zonës pilot janë tepër të rëndësishëm. Aksi rrugor me gjatësi 1.050km, i cili është kufiri i zonës pilot me përroin e Manazderes, vlerësohet si shumë i rëndësishëm pasi në studimin e perspektivës së zonës është paraqitur si aksi vertikal kryesor, duke bërë pjesë në elementet qytetformuese të Elbasanit. Gjithashtu, ky aks rrugor vlerësohet si i rëndësishëm edhe për faktin se lidh zonat e ndryshme me zonën bujqësore dhe atë ekonomike në periferi të qytetit të Elbasanit.

Megjithëse akset rrugore të zonës pilot kanë një rëndësi të veçantë për zhvillimin perspektiv të qytetit, gjendja e tyre e tanishme paraqitet e vështirë dhe hapësira e caktuar për rrugë të brendshme në zonë është shumë e vogël, duke bërë kështu që trafiku dhe transporti të zhvillohen nëpër rrugë të ngushta dhe jo të përshtatshme.

Rrugët janë ndërtuar nga vetë banorët, qoftë me pjesëmarrje individuale, qoftë të organizuar në mënyrë kolektive. Rrugët para shtëpive kanë një gjerësi relativisht të madhe: mesatarisht 3.4m. Banorët kanë investuar individualisht ose në grup për ndërtimin e rrugëve para shtëpive të tyre. Shuma e përgjithshme e këtyre investimeve kap shifrën totale prej 3.000 USD (e dhënë e marrë nga qendra komunitare), ku çdo familje ka shpenzuar mesatarisht 20 USD. Një pjesë e konsiderueshme e familjeve nuk kanë shpenzuar asnjë lek për shtrimin e rrugëve për shkak të gjendjes së tyre të varfër ekonomike.







Kanalizimet e ujërave të zeza


Gjendja e kanalizimeve në zonën pilot është e mjerueshme dhe shumë prej familjeve përdorin gropa septike. Gjithashtu, një pjesë e banorëve kanë bërë lidhje për derdhjen e ujërave të zeza direkt në përroin e Manazderes ose në përroin e Camurrit.

Vetëm disa prej tyre kanë lidhje me



linjat e kanalizimeve të qytetit apo me sistemin e ri të kanalizimeve të realizuar në kuadrin e projektit "Hapa drejt një Shoqërie gjithëpërfshirëse në Elbasan, integrimi i grupeve të prekura në zhvillimin urban" si bashkëfinancim i Bashkisë Elbasan me Co-PLAN (të dhëna të marra nga Bashkia Elbasan dhe studimi social-ekonomik i Co-PLAN).

Grafiku. Zgjidhja e problemit të kanalizimeve



Grafiku 6

Sipas Bashkisë Elbasan, fakti që banorët nuk paguajnë tarifën për shërbimin e kanalizimeve është një nga arsyet që ndikojnë në mungesën e investimeve, të mirëmbajtjes dhe të qëndrueshmërisë në kohë të këtij shërbimi.

Furnizimi me ujë

Kapacitetet e pamjaftueshme apo pamundësia e furnizimit me ujë të pijshëm e një pjese të konsiderueshme të zonës pilot vjen si rezultat i shkallës së lartë të amortizimit të sistemeve ekzistuese të shpërndarjes, të ndërhyrjeve të paligjshme në rrjet dhe të shtimit të konsumatorëve.

Gjithashtu ka një numër të konsiderueshëm lidhjesh të paligjshme dhe, në këto raste, ekziston edhe rreziku i ndotjes së ujit të pijshëm nga ujërat e zeza. (Megjithatë, një gjë e tillë nuk është raportuar). Shpesh problemet krijohen edhe për shkak të mungesës së koordinimit të duhur me urbanistikën. Sipas një vlerësimi të përafërt nga qendra komunitare rome, është llogaritur që në zonë mungon rreth 80% e rrjetit të ujësjellësit.

Energjia elektrike

Pothuajse të gjithë banorët e kësaj zone kanë akses në rrjetin elektrik, por furnizimi me energji elektrike është shumë i kufizuar dhe ky kufizim është justifikuar me konsumin e madh, shpërdorimin e energjisë dhe lidhjet e paligjshme, tarifat më të ulëta se kostoja, arkëtimet që nuk ekzistojnë si dhe investimet e pamjaftueshme në infrastrukturën fizike.

Furnizimit të pamjaftueshëm i shtohen edhe probleme të rrjetit si tensioni i ulët etj.. Të gjitha këto probleme shoqërohen nga një mungesë e investimeve shtetërore në zonë.

Shumica e familjeve (64.0%) kanë kontratë me KESH dhe matës






të energjisë elektrike; kështu, për rrjedhojë, u duhet të paguajnë për energjinë e harxhuar. Megjithatë, jo gjithnjë pasja e një kontrate çon në pagesën e detyrimeve. Në fakt, vetëm 48.0% paguajnë për energjinë e harxhuar (e dhënë e marrë nga rajoni).

Lidhja e këtyre familjeve në rrjetin elektrik është bërë kryesisht nga investime shtetërore, por nuk kanë munguar edhe lidhjet individuale apo kolektive. Sigurisht, këto të fundit futen në lidhjet e paligjshme, por gjithsesi banorët kanë të zgjidhur problemin e energjisë elektrike.

Mbledhja e mbeturinave urbane nga pikat kolektive të grumbullimit të mbeturinave në zonën pilot bëhet pothuajse çdo ditë. Nga ana e bashkisë është raportuar se çdo ditë mbeturinat e zonës pilot mblidhen në 5 pika të ndryshme. Megjithatë, në këtë zonë janë të dukshme pika grumbullimi ku mbeturinat nuk mblidhen rregullisht. Në shumë raste, përrenjtë që kalojnë pranë shërbejnë si vend për hedhjen e tyre.

Pavarësisht se një pjesë e banorëve i dërgojnë mbeturinat në vendgrumbullimet e duhura, një pjesë tjetër e madhe përdor rrugën më të shkurtër duke i djegur ato diku pranë shtëpisë apo diçka më larg saj dhe vetëm një numër i vogël familjesh i gropos.

Grafiku. Zgjidhja e problemit të mbeturinave



Grafiku 7

4.7 Mjedisi

Mjedisi në zonën pilot është tepër i ndotur dhe dy arsyet kryesore janë:

- Derdhja e ujërave të zeza në vende të hapura.
- Mbajtja e kafshëve shtëpiake nga banorët e zonës.

Përroi i Manazderes dhe ai i Camurrit përdoren gjithashtu shpesh si vende për hedhjen e plehrave. Kjo sjell bllokimin e tyre dhe, kur ndodh të bien shira të shumta, ata përmbytin tokat dhe shtëpitë e banorëve përreth. Ky ujë përmbytës rrezikon gjithashtu të ndotë

ujërat e puseve. Megjithëse pastrimi i përroit të Manazderes është bërë disa herë, problemi vazhdon të jetë i pranishëm përderisa nuk është zgjidhur çështja e menaxhimit të mbeturinave. Gjithashtu, zjarret e shpeshta në këtë zonë shkaktojnë ndotje të ajrit me dyoksid karboni, monoksid karboni, sulfur, oksid azoti dhe dioksinë.

Ndonëse komuniteti ka vazhduar ta kërkojë me shqetësim zgjidhjen e problemit të mbeturinave, duket qartë nga puna e deritanishme se ajo shikohet kryesisht si përgjegjësi e Bashkisë, ndërsa përgjegjësia e komunitetit për prodhimin dhe hedhjen e mbeturinave nuk është në nivelin e duhur.

Përmirësimi i kushteve të infrastrukturës në zonën pilot në qytetin e Elbasanit kërkon investime komplekse në mënyrë që zona të mund të integrohet me pjesën tjetër të qytetit. Megjithatë, banorët e kësaj zone kanë akses në çdo lloj shërbimi dhe ky akses është më i madh sesa pagesa që bëhet për të.

Grafiku 13. Aksesi dhe pagesa për shërbimet e ndryshme



Grafiku 8

Sipas specialistëve të bashkisë, ekzistenca e këtyre problemeve është rrjedhojë e ndërtimeve të paplanifikuara e kaotike dhe e shtimit të madh të popullsisë që ka ndodhur në këtë zonë sidomos vitet e fundit. Shpesh banorët, të detyruar nga nevoja e madhe për të sjellë në familjet e tyre shërbime parësore të tilla si furnizimi me energji apo me ujë të pijshëm, i kanë zgjidhur vetë këto probleme sipas mundësive që kanë pasur. Ndërhyrja e pushtetit vendor për t'u siguruar këtyre banorëve këto lloj shërbimesh ka qenë minimale, me përjashtim të disa rasteve të caktuara.

4.8 Aspektet sociale

Niveli i organizimit të komunitetit

Në kushtetutën e Shqipërisë shprehet qartë se të gjitha gruper dhe minoritetet kanë të drejtën e përfaqësimit në instanca të ndryshme. Por, kjo e drejtë themelore njihet vetëm nga një numër i kufizuar i popullsisë rome. Një pjesë dërrmuese e tyre mendojnë se nuk kanë të drejtë për t'u përfaqësuar dhe për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes në pushtetin lokal (e dhënë e marrë nga studimi social-ekonomik).


Komuniteti i zonës rome ka një nivel tepër

të ulët organizimi. Rreth 100 banorë janë anëtarë të organizatës me bazë komunitare.

Të pakta kanë qenë rastet kur ata janë mbledhur për të diskutuar problemet në zonë. Gratë rrallë herë kanë marrë pjesë në të tilla diskutime.

Problematikat gjinore në komunitetin Rom

Marrëdhëniet gjinore kanë gjithashtu një rëndësi të veçantë në këtë komunitet. Gratë shënojnë një shkallë më të lartë papunësie krahasuar me burrat në këto komunitete (e njëjta gjë ndodh dhe me popullsinë jo rome). Shkalla e punësimit për gratë rome në zonën pilot nuk arrin as 1%.



Grafiku 9

Dallimet gjinore në punësim mund të jenë një faktor tjetër i rëndësishëm që ndikon tek gratë rome. Ato kanë të ardhura më të ulëta se burrat romë dhe përballen me më shumë pengesa në përpjekjen për t'i shpëtuar varfërisë, për shkak të kufizimeve që ngadalësojnë mundësitë për zhvillimin e jetës së tyre. Gratë rome në komunitet merren kryesisht me punët e shtëpisë dhe kujdesin ndaj fëmijëve dhe shumë pak prej tyre edhe me tregtimin e rrobave të përdorura.

Grafiku. Roli i gruas në komunitet (përqindjet)

Ato martohen shumë herët, në një moshë mesatare 14-vjeçare, dhe në 90% të rasteve janë të paarsimuara (bëhet fjalë për arsimin e detyrueshëm).

Roli i gruas në vendimet e ndryshme në familjen rome është tepër i kufizuar. Ky rol përfshin vetëm vendimmarrje që kanë të bëjnë me lindjen dhe rritjen e fëmijëve dhe me blerjet e përditshme. Të gjitha llojet e tjera të vendimeve vijnë ekskluzivisht nga mashkulli dhe jo nga gruaja apo nga një vendim i përbashkët.

5 Objektivat Strategjikë të Zhvillimit të Zonës Pilot

Zhvillimi ekonomik

Zhvillimi ekonomik i zonës pilot merr në konsideratë kërkesat specifike të zhvillimit ekonomik të përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të Qytetit të Elbasanit.

Orientimi kryesor për zhvillimin ekonomik të kësaj zone është i lidhur drejtpërdrejt me rritjen e të ardhurave nëpërmjet punësimit dhe promovimit të aftësive të popullsisë rome për prodhimin e produkteve artizanale.

Zhvillimi urban

Ky objektiv kërkon përmirësimin e



rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm, përmirësimin e transportit publik, përmirësimin e ndriçimit rrugor etj..

Rritja e cilësisë së kësaj infrastrukture fizike për zonën pilot është në përputhje me planifikimin e zhvillimit urban për Qytetin e Elbasanit. Ky objektiv respekton parimet kryesore të Strategjisë së Zhvillimit të qytetit për planifikimin dhe zhvillimin urban të zonës pilot.

Zhvillimi mjedisor dhe shëndetësor

Përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës së mjedisit për zonën pilot do të kontribuojë në rritjen e cilësisë së ajrit e cila është e lidhur me menaxhimin e mirë të mbeturinave urbane, krijimin e hapësirave të gjelbra



dhe rritjen e nivelit të edukimit mjedisor të popullsisë së zonës pilot.

Zhvillimi kulturor dhe social
Përparësi do t'i jepet përmirësimit në përgjithësi të kushteve të jetesës së popullsisë që jeton në zonën pilot, veçanërisht përmes përmirësimit të kushteve të arsimimit dhe edukimit sidomos të të rinjve.



6 Objektivat dhe përparësitë e zhvillimit

Objektivat	Përparësitë e Zhvillimit
Zhvillimi ekonomik	• Ngritja e një qendre për edukimin profesional për të papunët romë • Panairi për promovimin e prodhimeve artizanale rome të paktën dy herë në vit • Rritja e përqindjes së punësimit të grave dhe vajzave rome që ka si rrjedhojë uljen e varfërisë • Ofrimi i trajnimit profesional pa pagesë
Zhvillimi urban	• Përfshirja e zonës pilot në sistemin e transportit urban • Përmirësimi i hapësirave publike në brendësi të zonës nëpërmjet prishjes së rrethimeve të banesave për sigurimin e hapësirave për objekte sociale • Rregullimi i sistemit rrugor • Përmirësimi i sistemit të ujit të pijshëm • Përmirësimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza • Përmirësimi i pllotë i përroit të Camurrit
Zhvillimi mjedisor dhe shëndetësor	• Aktivitetet e pakësimit/riciklimit të mbeturinave nëpërmjet pjesëmarrjes së komunitetit. Sigurimi i të ardhurave përmes aktiviteteve të riciklimit të mbeturinave dhe krijimit të industrisë së riciklimit në nivel lokal • Sigurimi i një toke të lirë në zonën pilot për të krijuar një park apo zonë të gjelbër e cila të integrohet me pjesën e gjelbër që zbret nga kodra pranë përroit të Camurrit • Mbjellja e pemëve – breza mbrojtës përgjatë përroit të Manazderes, në brendësi të zonës pilot, nëpër rrugë etj.
Zhvillimi kulturor dhe social	• Krijimi i një biblioteke me libra në gjuhën rome • Ngritja e një shkolle të mesme profesionale • Regjistrimi i fëmijëve romë në arsimin parashkollor • Ndërtimi i një qendre kulturore për të rinjtë dhe familjet • Rritja e shkallës së arsimimit të fëmijëve të komunitetit rom që do të ndikojë pozitivisht në parandalimin e fenomeneve sociale

Planet e veprimit

Pjesa më e vështirë, si në procesin e hartimit të dokumentit ashtu edhe në realizimin e tij, është plani i veprimit. Sipas përkufizimit të përdorur nga fondet strukturore të BE-së, Plani i Veprimit përmban programe, nënprogramet përkatëse dhe masat për të zbatuar prioritetet e ndryshme.

Hartimi dhe zhvillimi i planit të veprimit i lejon të gjitha grupet e interesuara të bëhen pjesë në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e hapave me qëllim arritjen e objektivit madhor të integrimit të zonës pilot.

Më poshtë paraqiten planet e veprimit (Shtojca 3) të zhvilluara nga grupet e punës. Në këto plane janë përfshirë edhe komentet e sugjerimet e marra nga takimet në zonë. Planet e veprimit u grupuan sipas tematikave specifike/objektivave për të thjeshtuar menaxhimin dhe koordinimin e tyre nga grupet e punës.

dhe rritjen e nivelit të edukimit mjedisor të popullsisë së zonës pilot.

Zhvillimi kulturor dhe social
Përparësi do t'i jepet përmirësimit në përgjithësi të kushteve të jetesës së popullsisë që jeton në zonën pilot, veçanërisht përmes përmirësimit të kushteve të arsimimit dhe edukimit sidomos të të rinjve.



6 Objektivat dhe përparësitë e zhvillimit

Objektivat	Përparësitë e Zhvillimit
Zhvillimi ekonomik	• Ngritja e një qendre për edukimin profesional për të papunët romë • Panairi për promovimin e prodhimeve artizanale rome të paktën dy herë në vit • Rritja e përqindjes së punësimit të grave dhe vajzave rome që ka si rrjedhojë uljen e varfërisë • Ofrimi i trajnimit profesional pa pagesë
Zhvillimi urban	• Përfshirja e zonës pilot në sistemin e transportit urban • Përmirësimi i hapësirave publike në brendësi të zonës nëpërmjet prishjes së rrethimeve të banesave për sigurimin e hapësirave për objekte sociale • Rregullimi i sistemit rrugor • Përmirësimi i sistemit të ujit të pijshëm • Përmirësimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza • Përmirësimi i pllotë i përroit të Camurrit
Zhvillimi mjedisor dhe shëndetësor	• Aktivitetet e pakësimit/riciklimit të mbeturinave nëpërmjet pjesëmarrjes së komunitetit. Sigurimi i të ardhurave përmes aktiviteteve të riciklimit të mbeturinave dhe krijimit të industrisë së riciklimit në nivel lokal • Sigurimi i një toke të lirë në zonën pilot për të krijuar një park apo zonë të gjelbër e cila të integrohet me pjesën e gjelbër që zbret nga kodra pranë përroit të Camurrit • Mbjellja e pemëve – breza mbrojtës përgjatë përroit të Manazderes, në brendësi të zonës pilot, nëpër rrugë etj.
Zhvillimi kulturor dhe social	• Krijimi i një biblioteke me libra në gjuhën rome • Ngritja e një shkolle të mesme profesionale • Regjistrimi i fëmijëve romë në arsimin parashkollor • Ndërtimi i një qendre kulturore për të rinjtë dhe familjet • Rritja e shkallës së arsimimit të fëmijëve të komunitetit rom që do të ndikojë pozitivisht në parandalimin e fenomeneve sociale

Planet e veprimit

Pjesa më e vështirë, si në procesin e hartimit të dokumentit ashtu edhe në realizimin e tij, është plani i veprimit. Sipas përkufizimit të përdorur nga fondet strukturore të BE-së, Plani i Veprimit përmban programe, nënprogramet përkatëse dhe masat për të zbatuar prioritetet e ndryshme.

Hartimi dhe zhvillimi i planit të veprimit i lejon të gjitha grupet e interesuara të bëhen pjesë në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e hapave me qëllim arritjen e objektivit madhor të integrimit të zonës pilot.

Më poshtë paraqiten planet e veprimit (Shtojca 3) të zhvilluara nga grupet e punës. Në këto plane janë përfshirë edhe komentet e sugjerimet e marra nga takimet në zonë. Planet e veprimit u grupuan sipas tematikave specifike/objektivave për të thjeshtuar menaxhimin dhe koordinimin e tyre nga grupet e punës.

praktike të zhvillimit të qëndrueshëm, përgatitjen e prezantimeve dhe paraqitjen e tyre, menaxhimin e projekteve, punën në grup, monitorimin dhe raportimin. Në rastin e zonës pilot, të kuptuarit e këtyre elementeve që mjaft i kufizuar. Megjithatë, përfshirja më e madhe e ekspertëve dhe kryerja e një sërë trajnimeve për rritjen e kapaciteteve do të mund të ndihmojnë në rritjen e nivelit të informacionit të pjesëmarrësve në proces.

Një përfaqësim sa më i gjerë i të gjithë aktorëve në grupet e punës do të ndihmonte në rritjen e shkallës së transparencës. Gjithashtu kjo ndihmon që procesi i integrimit të romëve të mos shihet vetëm si detyrim i pushtetit lokal por i mbarë segmenteve që përfaqësojnë komunitetin. Në rast se ky proces do të përsëritet në lagje të tjera, duhet bërë kujdes që të sigurohet angazhimi i vërtetë i pjesëmarrësve duke organizuar një proces sa më gjithëpërfshirës në përcaktimin e prioriteteve dhe hartimin e planeve të veprimit.

Për sa i përket planifikimit të Bashkisë për zonën pilot, këto prioritete do të merren në konsideratë, megjithëse realizimi i të gjitha planeve do të varet shumë nga insistimi i komunitetit për t'i ndjekur ato, nga gjetja e fondeve dhe nga partneritetet.

Një grup drejtuesish dhe përfaqësuesish nga komuniteti dhe Bashkia kërkohet të udhëheqë procesin e realizimit të planeve të veprimit. Duhet që OBK-ja dhe Rajoni 6 të marrin rolin drejtues të identifikimit të njerëzve kyç që do të përgatisin zhvillimin, lobingun dhe aktivizimin e anëtarëve të tjerë të komunitetit, Bashkisë dhe donatorëve për të çuar përpara Planet e Veprimit.

Duke ditur që proceset e vendimmarrjes komunitare në pushtetin lokal janë akoma në hapat e para, është e nevojshme që të forcohen kapacitetet e stafit të bashkisë dhe të OBK-ve nëpërmjet projekteve "të zhvillimit të kapaciteteve" duke inkurajuar përfshirjen e romëve në projekte të mirëfillta bashkëpunimi me pushtetin lokal për zhvillimet në zonë. Gjithashtu duhet të promovohet edhe bashkëpunimi ndërbashkiak për të mundësuar realizimin e këtij programi.

Zbatimi i planeve të veprimit të Programit të Zhvillimit të zonës pilot nga të gjithë aktorët lokalë të përfshirë në hartimin e dokumentit nën drejtimin dhe koordinimin e rajonit numër 6, Bashkia Elbasan.

Përfshirja e dokumentit të zhvillimit të zonës pilot në politikat e zhvillimit urban, ekonomik dhe social që zhvillon bashkia për qytetin e Elbasanit. Kjo do të dëshmojë seriozitetin e pushtetit lokal ndaj kërkesave të banorëve dhe do të jetë një model i shkëlqyer i planifikimit nga poshtë lart.

Përditësimi periodik i të gjitha këtyre në mënyrë që të marrin në konsideratë progresin e përvitshëm të zonës pilot, ecurinë e zbatimit të programeve dhe projekteve që financohen dhe efektin e tyre.

Parimetemësipërmeduhettëkthehen në politika, programe dhe projekte konkrete nga ana e Bashkisë Elbasan dhe duhet të krijohet mundësia që ato të përcillen brenda një kuadri zhvillimi me bazë në zonë. Përfundimisht, një dialog i përmirësuar, një komunikim institucional i shoqëruar me plane konkrete mes banorëve, pushtetit lokal dhe institucioneve shtetërore, është themelor për integrimin dhe zhvillimin e komunitetit rom.

PLANI I VEPRIMIT PËR: "Zhvillimin ekonomik" Projekti 1

Projekti: Ngritja e një qendre të edukimit Professional (QEP) për të papunët romë				
Objektivi: Përmirësimi i kushteve social-ekonomike të komunitetit rom				
Veprimet e nevojshme	**Kush do të përfshihet**	**Fondet**	**Koha e nevojshme**	**Treguesit e suksesit**
1. Ngritja e një grupi koordinimi për të drejtuar themelimin e QEP nga zyra e punës në Elbasan. 2. Kryerja e një analize lidhur me nevojat për kurse të personave që janë duke kërkuar punë dhe llojet e kurseve për të cilat ata janë të interesuar apo që janë të aftë të kryejnë. 3. Identifikimi dhe kontaktimi i mësuesve dhe trajnuesve të praktikës. 4. Identifikimi i një ndërtese ekzistuese (e cila të mund të përdoret gjatë pasdites për zhvillimin e kurseve) dhe i hapave që duhet të ndërmerren për të marrë objektet në pronësi apo për përdorimin e tyre të përkohshëm. 5. Formulimi i programit mësimor (ndërtim, elektrik, hidraulik, sekretari, rrobaqepësi etj.) bazuar në analizat e nevojave për trajnim dhe mendimet e trajnuesve. 6. Gjetja e punëdhënësve të cilët mund të marrin në punë nxënësit e kësaj shkolle si pjesë e programit mësimor. 7. Fillimi i një fushate për të tërhequr sa më shumë pjesëmarrës duke shpjeguar përfitimet e mundshme nga pjesëmarrja në QEP. Konfirmimi i niveleve të pjesëmarrjes dhe numri i pjesëmarrjes sipas kurseve. 8. Kontaktimi me Bashkinë, biznesmenët e qytetit, donatorë të mundshëm, shoqata dhe OJQ. Kërkimi i donacioneve e kontributeve si dhe i angazhimeve nga organizatat lokale – private dhe publike. 9. Formulimi i një projekt-propozimi i cili do të përmbledhë të gjitha hapat e ndërmarra dhe ato që do të ndërmerren për t'iu paraqitur donatorëve, shoqatave dhe OJQ-ve.	**Roli drejtues**: Zyra e punësimit Elbasan Bashkia Drejtorët e shkollave Drejtoria Arsimore në Elbasan Biznesmenët Donatorët e mundshëm dhe OJQ-të Mësuesit/Profesionistë me eksperiencë praktike	Huazim paraprak i pagesës së kurseve bazuar mbi një kontratë sipas cilës kursanti duhet t'i kthejë paratë në momentin e parë të punësimit Fonde të mundshme nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Punës dhe Përkrahjes Sociale Fonde të mundshme nga OJQ të cilat kanë si objektiv të tyre arsimimin dhe edukimin e popullsisë rome	Janar-Shkurt 2010 për pikat 1, 2, 3 Mars-Prill 2010 për pikat 4, 5, 6 Maj 2010 për pikat 7, 8 Qershor 2010 pika 9	Përqindja e të papunëve të cilët gjejnë punë pas përfundimit të këtij kursi Ulja e papunësisë në zonën pilot

Shtojcë

PLANI I VEPRIMIT PËR: "Zhvillimin kulturor dhe social" Projekti 2

Projekti: Ndërtimi i një shkolle të mesme me drejtim profesional				
Objektivi: Edukim bazë për të gjithë				
Veprimet e nevojshme	**Kush do të përfshihet**	**Fondet**	**Koha e nevojshme**	**Treguesit e suksesit**
1. Drejtoria Arsimore në bashkëpunim me bashkinë themelojnë një Grup Pune me anëtarë nga të dy institucionet dhe me përfaqësues nga organizata me bazë komunitare e nga bizneset. 2. Grupi i Punës kryen analiza dhe takime për të identifikuar nevojat që paraqiten për ndërtimin e shkolliës (tokë, ndërtesa, pajisje etj.). Ky grup pune duhet të koordinojë punën me grupin tjetër për informimin e komunitetit në nivel lagjeje lidhur me regjistrimin e të rinjve. 3. Grupi i Punës vendos kontakte me Ministrinë e Arsimit (nëpërmjet Drejtorisë Arsimore) për të formuluar një program investimi afatshkurtër (sipas analizave të mësipërme) dhe afatgjatë për Elbasanin. 4. Grupi i Punës kryen punë kërkimore për të identifikuar donatorë apo projekte të ndryshme që përputhen me objektivin (Banka Botërore, CRS, Soros etj.) për të mbuluar një pjesë të investimit. 5. Pjesëmarrësit lokalë (banorë, pushtet lokal etj.) kontaktojnë donatorët dhe paraqesin planin e detajuar të veprimeve me kostot përkatëse dhe veprimet e ndërmarra deri në atë moment. 6. Aktorët realizojnë ndërtimin e shkollës pranë zonës pilot.	**Roli drejtues**: Drejtoria Arsimore e Elbasanit Ministria e Arsimit Seksionet e Planifikimit Urban dhe Punëve Publike Deputeti i zonës Drejtorët e shkollave	Drejtoria Arsimore në Elbasan nëpërmjet Ministrisë së Arsimit Donatore të mundshëm, fondacione të cilat kanë për objektiv kryesor edukimin dhe arsimimin. OJQ (Banka Botërore, CRS, Soros etj.) Pushteti lokal	Janar 2011 pika 1 Shkurt-Mars 2011 pika 2 Prill 2011 pika 3 Maj-Qershor 2011 pika 4 Korrik-Gusht 2011 pika 5 Shtator 2011-Shkurt 2012 pika 6	Një shkollë e ndërtuar Rritja e numrit të të rinjve rome në moshë shkolle të cilët ndjekin procesin mësimor

PLANI I VEPRIMIT PËR: "Zhvillimin ekonomik" Projekti 3

Projekti: Panair për promovimin e prodhimeve artizanale rome të paktën dy herë në vit				
Objektivi: Përmirësimi i kushteve social-ekonomike të komunitetit rom				
Veprimet e nevojshme	**Kush do të përfshihet**	**Fondet**	**Koha e nevojshme**	**Treguesit e suksesit**
1. Themelimi i grupit iniciator me përfaqësues të komunitetit të cilët merren me punime artizanati, për ndjekjen e hapave për realizimin e objektivit. 2. Fillimi i një fushate sensibilizimi dhe marketimi për të tërhequr një numër sa më të madh artizanësh duke shpjeguar përfitimet që mund të vijnë nga dhënia e kontributit për themelimin e këtij panairi. 3. Identifikimi i nevojave për asistencë teknike në përgatitjen e të gjitha hapave të planit të veprimit. 4. Kontaktimi i OJQ-ve që punojnë në fushën e promovimeve të artizanatit. 5. Identifikimi i nevojave për tokë dhe ndërtesë (sheshi pranë kalasë së qytetit është një tokë e cila mund të përdoret për treg të hapur). 6. Organizimi i takimeve me përfaqësues të bashkisë për të pasur mbështetje në realizimin e idesë dhe ndihmesë në gjetjen e një vendi të përshtatshëm dhe në marrjen e lejes. 7. Identifikimi i nevojave dhe i kostove për përshtatjen e ndërtesës apo tregut. 8. Formulimi i një propozimi dhe plani biznesi për ta qarkulluar në komunitetin e artizanëve në mënyrë që të merren komentet dhe mbështetja e tyre. 9. Paraqitja e planit të biznesit bashkisë, përfaqësuesve të biznesit dhe gjithë kontribuuesve të mundshëm.	**Roli drejtues**: Grupi iniciator i Artizanëve Përfaqësues nga shoqata e komunitetit Bashkia Rajoni OJQ të interesuara	Pushteti lokal Donatore të ndryshëm	Janar-Shkurt 2009 për pikat 1,2,3,4 Mars 2009 pika 5 Prill 2009 për pikat 6,7 Maj-Qershor 2009 për pikat 8,9 Nga grupet e punës është rekomanduar që panairet të organizohen gjatë muajve të Qershorit dhe Nentorit	Numri i artizanëve të cilët marrin pjesë dhe kontribuojnë në realizimin e tregut. Numri i inicativave të reja të përfshira në aktivitetet e promovimit të punimeve të artizanatit rom

PLANI I VEPRIMIT PËR "Zhvillimin mjedisor dhe shëndetësor" Projekti 3

Projekti: Të sigurohet tokë e lirë në zonën pilot për të krijuar një park apo zonë të gjelbër e cila të integrohet me pjesën e gjelbër që zbret nga kodra pranë përroit të Camurrit

Krijimi i zonave çlodhëse për komunitetin

Objektivi: Sigurimi i një mjedisi të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm

Veprimet e nevojshme	Kush do të përfshihet	Fondet	Koha e nevojshme	Treguesit e suksesit
1. Krijimi i grupit të punës "Për një lagje të gjelbër" nga ana e Bashkisë duke përfshirë edhe përfaqësues të komunitetit.	**Roli drejtues** Bashkia	Drejtoria e Shërbimit Pyjor	Shtator 2010 për pikat 1,2	Numri i pemëve të mbjella
2. Identifikimi i zonave ku brezat e gjelbër mund të jenë më efektivë në lidhje me drejtimin e erërave dhe gazrave që çlirohen nga metalurgjiku dhe fabrika e çimentos (të merren parasysh zonat të cilat më parë kanë qenë të mbuluara me agrume, zonat përgjatë përroit, në shpate të kodrave dhe zona të tjera).	Prefektura			
3. Formulimi i projektit "për një lagje të gjelbër", i cili do të bëjë lidhjen fizike të zonës pilot me zonat e gjelbra natyrore jashtë saj.	Drejtoria e Shërbimit Pyjor	Kontributi i nxënësve të shkollave dhe i komunitetit përmjet punës	Tetor-Dhjetor 2011 pika 3,4	Numri i brezave të gjelbra të krijuara Përmirësimi i cilësisë së ajrit në zonën pilot dhe në qytet
4. Vendosja e kontakteve dhe sigurimi i mbështetjes nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Ndërmarrja e Gjelbërimit, Prefektura dhe komunat përreth.	Komunat		Janar-Prill 2011 pika 5,6	
5. Fillimi i një fushate sensibilizimi me banorët, nxënësit e shkollave dhe të rinjtë për të "festuar" ditën e mjedisit. Shpjegimi i përfitimeve të banorëve lidhur me pastërtinë e ajrit, reduktimin e pluhurave, freskinë dhe hijen gjatë verës, zvogëlimin e rrezikut të rrëshqitjeve të truallit dhe krijimin e zonave për qëllime çlodhjeje. Caktimi i një dite për nxënësit e shkollave gjatë të cilës ata do të mbjellin fara pemësh dhe do të fillojnë të kujdesen për rritjen e tyre gjatë gjithë kohës. Krijimi i një liste ku banorët e zonës pilot do të shënojnë emrin për të mbjellë pemë dhe për t'i vendosur pemës emrin e tyre në zonën e gjelbër që do të krijohet.	Organizatat me bazë Komunitare	OJQ të mjedisit si p.sh. GEF, REC		
6. Kontaktimi dhe lidhja e interesave të biznesmenëve të qytetit si edhe e OJQ-ve vendase e të huaja me idenë e krijimit të brezave të gjelbër; sponsorizimi nga ana e tyre dhe reklamimi nëpërmjet vënies së emrave të pemëve.	Drejtorët e shkollave		Maj 2011 pika 7,8	
7. Formulimi i një plani veprimi të detajuar i cili do të tregojë numrin e pemëve që do të mbillen sipas ditëve dhe vendeve të caktuara, përfshirjen e nxënësve dhe të komunitetit, sponsorët sipas ditëve të ndryshme dhe mënyrën e përkujdesjes për to (këto veprimtari duhet të kryhen të paktën gjatë periudhës së pyllëzimit Nëntor-Mars).	Drejtoria Arsimore			
8. Përzgjedhja e pemëve lokale që përshtaten më shumë me klimën e vendit dhe minimizojnë shpenzimet e mirëmbajtjes dhe të ujitjes. Përcaktimi i mënyrës së mirëmbajtjes.	Biznesmenët			
9. Kontaktimi dhe gjetja e mënyrave për të lidhur interesat e sektorit privat të qytetit dhe tregtarëve të vegjël përgjatë rrugëve me idenë e gjelbërimit të po këtyre rrugëve. Lidhja e interesave të sponsorizimit me ato të gjelbërimit të zonave të ndryshme të qytetit.	OJQ të mjedisit në Elbasan, Tiranë etj.		Qershor 2011 pika 9	

PLANI I VEPRIMIT PËR "Zhvillimin mjedisor dhe shëndetësor" Projekti 3

Projekti: Aktivitetet e pakësimit/riciklimit të mbeturinave nëpërmjet pjesëmarrjes së komunitetit. Sigurimi i të ardhurave përmes aktiviteteve të riciklimit të mbeturinave dhe krijimit të industrisë së riciklimit në nivel lokal.

Objektivi: Sigurimi i një mjedisi të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm

Varianti 2: Reduktimi i mbeturinave, përmirësimi i grumbullimit dhe ripërdorimi i tyre.

Veprimet e nevojshme	Kush do të përfshihet	Fondet	Koha e nevojshme	Treguesit e suksesit
1. Krijimi nga ana e Bashkisë i grupit të punës "Për një lagje të pastër" me përfaqësues nga institucionet, grupet etj. të renditura në kolonën përbri.	**Roli drejtues** Bashkia, Seksioni i Shërbimeve Publike	Pushtetë lokal nëpërmjet ndërmarrjes së pastrimit-gjelberimit	Janar 2013 pika 1	Përqindja e mbeturinave që mbledhen
2. Fillimi i një fushate sensibilizimi dhe edukimi për të gjetur mënyra të tjera të hedhjes dhe grumbullimit të mbeturinave.			Shkurt-Maj 2013 pikat 2,3,4	Përqindja e mbeturinave që ripërdoren përkundrejt atyre që hidhen dhe digjen
3. Hyrja a grupit të punës në bisedime me rrëmuesit e mbeturinave dhe ndërmarrjet private të cilat ripërdorin disa nga mbeturinat për të gjetur rrugë të tjera për rritjen e sasisë së mbeturinave që mund të ripërdoren.	Shoqata e komunitetit dhe organizata të tjera	Sektori privat		
4. Vendosja e kontakteve midis grupit të punës dhe Organizatave me Bazë Komunitare, grupeve të tjera të komunitetit dhe OJQ-ve, për të gjetur mundësinë e ndarjes së mbeturinave në mënyrë që të lehtësohet procesi i ripërdorimit. Këtu mund të përfshihet kompostimi i mbeturinave organike.	OJQ ambientaliste në Elbasan, Tiranë dhe më gjerë			
5. Identifikimi i mundësive dhe nevojave për të lehtësuar ripërdorimin e mbeturinave në varësi të gatishmërisë dhe interesit të komunitetit për të realizuar ndarjen e mbeturinave shtëpiake, interesave të sektorit privat dhe riciklimit në zonë. Kjo mund të kërkojë shtimin e pikave të grumbullimit, rritjen e ndërgjegjësimit për të nxitur ndarjen e mbeturinave dhe marrëveshje me ndërmarrjet private dhe rrëmuesit.	Drejtoria e Shërbimit Publik Rrëmuesit e plehrave	Donatorë për përmirësimin e pikave të grumbullimit	Qershor 2013 pika 5	Përmirësimi i cilësisë së mjedisit
6. Paraqitja e këtij plani veprimi për të thithur investimet e duhura duke theksuar veprimet që do të jenë ndërmarrë deri në atë kohë nga komuniteti.	Drejtorët e shkollave dhe mësuesit		Shtator 2013 pika 6	Niveli i përfshirjes së komunitetit në proces
7. Caktimi i një dite për pastrimin e disa prej vendderdhjeve të zonës pilot siç është p.sh. përroi i Manazderes apo i Camurrit. Promovimi i edukimit lidhur me derdhjen e mbeturinave dhe kombinimi i pastrimit me zbatimin e projekteve të gjelbërimit.	Kontraktorë privatë dhe përfaqësues të sektorit privat		Tetor 2013 pika 7	

PLANI I VEPRIMIT PËR "Planifikimin urban" Projekti 1

Projekti: Përmirësimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza				
Objektivi: Përmirësimi i cilësisë së mjedisit urban				
Veprimet e nevojshme	**Kush do të përfshihet**	**Fondet**	**Koha e nevojshme**	**Treguesit e suksesit**
1. Grupi i punës koordinon një studim i cili do të detajojë problemet e gjendjes ekzistuese të kanalizimeve në nivel lagjeje, zonat e pambuluara me shërbim, dëmtimet në rrjet (primar, sekondar, terciar), natyrën dhe shkallën e problemeve, prioritetin e ndërhyrjeve si edhe çdo problem tjetër.	**Roli kryesor**: Seksioni i punëve publike në Bashki	Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	Janar 2010 pika 1	Rritja e përqindjes së banesave në zonën pilot të cilat përmirësojnë sistemin e kanalizimeve
2. Bazuar në nevojat dhe prioritetet e identifikuara, formulohet një plan veprimi i detajuar për të gjitha problemet i cili do të përfshijë edhe kostot, prioritetet dhe burimin e mundshëm të financimit për secilin prej tyre.	Seksioni i Planifikimit Urban në Bashki	Bashkia	Shkurt 2010 pika 2	
3. Grupi i punës vendos kontakte me autoritete më të larta të pushtetit lokal duke përcaktuar një program investimi afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër.	Ndërmarrja e furnizimit të ujit dhe kanalizimeve në Elbasan	Biznese të cilat shkarkojnë ujërat e zeza në përrenj	Mars 2010 pika 3	Numri i banesave të reja të cilat mbulohen nga shërbimi i kanalizimeve
4. Grupi i punës fillon një fushatë sensibilizimi me biznesmenët dhe komunitetin dhe diskuton me ta për mënyra të ndryshme financimi dhe për nevojën për kontributin e tyre. Gjithashtu diskuton edhe lidhur me probleme të përdorimit dhe mirëmbajtjes.			Prill-Maj 2010 pika 4	
5. Grupi i punës fillon një fushatë kërkimi edhe në donatorë të tjerë si Banka Botërore, Fondi Shqiptar i Zhvillimit etj. për të mbuluar një pjesë të investimit. Ai harton dhe paraqet projekt-propozime.	Biznese të cilat shkarkojnë ujërat e zeza në përroin e Manazderes	Banorët e zonave problematike (me një pjesë të investimit që mund të shkojë 10-20% për rrjetin sekondar)	Qershor-Korrik 2010 pika 5	Përmirësimi i cilësisë së mjedisit në zonat ku ka mungesë të kanalizimeve dhe probleme të rjetit
6. Realizimi i investimit	Banorë të zonës pilot		Dhjetor 2010 pika 6	

PLANI I VEPRIMIT PËR "Zhvillimin kulturor dhe social" Projekti 3

Projekti: Regjistrimi i fëmijëve në arsimin parashkollor				
Objektivi: Edukim bazë për të gjithë				
Veprimet e nevojshme	**Kush do të përfshihet**	**Fondet**	**Koha e nevojshme**	**Treguesit e suksesit**
1. Krijimi i grupit të punës nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale për të kryer një studim lidhur me analfabetizmin e popullsisë rome.	**Roli drejtues** Drejtoria Arsimore	Ministria e Arsimit	Maj 2009 pika 1	Një studim i kryer
2. Përdorimi i gjithë informacionit lidhur me monitorimin e problemeve të analfabetizmit dhe shkaqet e tij për hartimin e një programi të posaçëm.	Pushteti lokal	Ministria e Punës dhe Shanseve të Barabarta	Korrik 2009 pika 2,3,4	Identifikimi i numrit të analfabetëve në zonën pilot
3. Identifikimi i numrit të analfabetëve dhe ndarja e tyre sipas grupmoshave.	OJF që punojnë në fushën e arsimit			
4. Rënia dakord për hapat që do të ndërmerren dhe formulimi i një projekt-propozimi i cili do të detajojë më tutje këto hapa si edhe kostot dhe kohën që nevojitet për të ndryshuar gjendjen e analfabetizmit; këto do të jenë pjesë e planit të punës së drejtorisë arsimore.		Fondacione ndërkombëtare të cilat kanë për objektiv arsimin		
5. Formulimi i një liste donatorësh të mundshëm dhe dërgimi i projekt- propozimit për financim.	Shkollat 8-vjeçare të cilat ndodhen pranë zonës pilot		Shtator 2009 pika 5,6	Përmirësimi i niveli arsimor
6. Regjistrimi i fëmijëve Rom në shkollat publike.				

PLAN VEPRIMI PËR: "Zhvillimin kulturor dhe social" Projekti 2

Projekti: Hapja e një biblioteke e cila do të pasurohet me libra në gjuhën rome				
Objektivi: Edukim bazë për të gjithë				
Veprimet e nevojshme	**Kush do të përfshihet**	**Fondet**	**Koha e nevojshme**	**Treguesit e suksesit**
1. Ngritja e grupit iniciator që përfshin përfaqësues nga të gjitha institucionet e interesuara për hapjen e një biblioteke të përhershme në zonën pilot.	**Roli kryesor** Grupi iniciator, Bashkia, OJF, komuniteti	Bashkia	Dhjetor 2008 pikat 1,2	Hapja e një biblioteke
2. Identifikimi i vendeve të mundshme për bibliotekën rome (në qoftë se është e mundur, të përdoren ambientet e qendrës sociale ekzistuese).	Ministria e Kulturës			
3. Identifikimi i nevojave për libra në gjuhën rome, magazinimi i librave dhe sigurimi i rafteve dhe i vendeve për t'u ulur.	Deputeti i zonës	Drejtoria e Kulturës dhe Ministria e Kulturës		
4. Identifikimi i burimeve – njerëzore, operative dhe financiare – që nevojiten për të hapur bibliotekën mbi baza të rregullta dhe i mundësive për staf vullnetar, p.sh. studentë, për të operuar sistemin e dhënies së librave.	Drejtoria e Kulturës		Janar-Shkurt 2009 pikat 3,4	Rritja e numrit të librave në gjuhën rome në bibliotekë dhe pajisja e saj me një sallë leximi
5. Miratimi i pronësisë ose i qerasë së ndërtesës së identifikuar. Miratimi i një skeme dhe i stafit operativ dhe identifikimi i burimeve të kostove operacionale.	Prefektura			
6. Sensibilizimi i Ministrisë së Kulturës, institucioneve shtetërore, sektorit privat dhe fondacioneve ndërkombëtare për dhurimin e librave të rinj në bibliotekë.	Shoqata kulturore të ndryshme		Mars 2009 pika 5	
7. Hapja e bibliotekës.	Biznesmenë të qytetit		Prill 2009 pika 6	Numri i librave të marrë nga biblioteka mbi bazë mujore
			Maj 2009 pika 7	

PLAN VEPRIMI PËR "Zhvillimin kulturor dhe social" Projekti 4

Projekti: Qendra kulturore për të rinjtë dhe fëmijët				
Objektivi: Edukim bazë për të gjithë				
Veprimet e nevojshme	**Kush do të përfshihet**	**Fondet**	**Koha e nevojshme**	**Treguesit e suksesit**
1. Ngritja e grupit iniciator të përbërë nga përfaqësues të rajonit dhe komunitetit dhe përfaqësues nga të gjitha institucionet e interesuara për hapjen e një qendre rinore në zonën pilot.	**Roli Kryesor** Grupi iniciator	Bashkia	Janar 2001 pika 1	Të rinjtë e zonës pilot, por jo vetëm ata, kanë një qendër kulturore
2. Kryerja e një studimi për tregun; konfirmimi i kërkesës së komunitetit për të hapur qendrën dhe përcaktimi i vendndodhjes.	Bashkia		Shkurt 2012 pika 2	
3. Identifikimi i burimeve – njerëzore, operative dhe financiare – që nevojiten për të hapur qendrën mbi baza të rregullta. Studimi i mundësive për përfshirjen e sektorit privat në Elbasan.	Klubi Sportiv	Përfaqësues të Biznesit	Mars-Prill 2012 pika 3	Përqindja e popullsisë që përdor qendrën
4. Përgatitja e konceptit të projekt-propozimit me përllogaritjet e kostove dhe një plan biznesi për t'iu paraqitur donatorëve të mundshëm dhe sektorit privat.	Drejtoria e Arsimit		Maj-Qershor 2012 pika 4	
5. Kontaktimi i donatorëve të mundshëm nga pushteti lokal, sektori i biznesit të qytetit dhe OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare për donacione financiare dhe kontribute në natyrë.	Përfaqësues të Biznesit	OJF	Shtator-Dhjetor 2012 pika 5	Rritja e nivelit kulturor, social dhe edukativ të të rinjve dhe fëmijëve
6. Identifikimi i shumës së secilit kontribuues në investim.	Komuniteti		Janar-Mars 2012 pika 6,7	
7. Formulimi i një plani veprimi të detajuar sipas të cilit do të funksionojë qendra.				

PLANI I VEPRIMIT PËR: "Zhvillimin urban" Projekti 3

Projekti: Përmirësimi i sistemit rrugor, furnizimit me ujë të pijshëm				
Objektivi: Përmirësimi i cilësisë së mjedisit urban				
Veprimet e nevojshme	**Kush do të përfshihet**	**Fondet**	**Koha e nevojshme**	**Treguesit e suksesit**
1. Formulimi i një plani veprimi me kostot përkatëse që përfshin zgjerimin e unazës kryesore dhe të rrugëve brenda zonës pilot së bashku me trotuaret, kanalizimet e rrugëve kryesore, ristrukturimin e urave që kalojnë mbi përroin e Manazderes dhe përmirësimin e ndriçimit publik. Përfshirja e opsioneve të tjera të qëndrueshme si krijimi i zonave vetëm për këmbësorë.	**Roli kryesor:** Grupi iniciator	Bashkia	Janar-Shkurt 2012 pika 1	Përmirësimi i plotë i kushteve mjedisore, sociale, urbane dhe shëndetësore
2. Paraqitja e idesë para komunitetit të biznesit dhe Këshillit Bashkiak të Elbasanit. Kërkimi i sponsorizimeve dhe i kontributeve në natyrë për ndriçimin e rrugëve dhe përmirësimin e trotuareve.	Bashkia	Donatorë të mundshëm ndërkombëtarë. FSHZH, Banka Botërore	Mars 2012 pika 2	Integrimi më i shpejtë i banorëve të kësaj zone.
3. Formulimi i projekteve teknike të veprimit me miratimin e investimeve nga Bashkia dhe sektori privat.	Përfaqësuesit e Biznesit	Kontribute nga komuniteti	Prill-Maj 2012 pika 3	
4. Hartimi i projekt-propozimeve për t'u paraqitur pranë bashkisë dhe donatorëve për financimin e alternativave të reja të qëndrueshme të përmirësimit të infrastrukturës të cilat nuk mbulohen nga fonde lokale.	Zyra e Urbanistikës	Sektori i Biznesit	Qershor-Gusht 2012 pika 4	
5. Realizimi i investimeve			Janar-Dhjetor 2012 pika 5	

PLANI I VEPRIMIT PËR: "Planifikimin urban" Projekti 5

Objektivi: Përmirësimi i hapësirave publike në brendësi të zonës pilot me prishjen e rrethimeve të banesave të vendosura nga persona privatë, për ndërtimin e objekteve sociale				
Objektivi: Përmirësimi i cilësisë së mjedisit urban				
Veprimet e nevojshme	**Kush do të përfshihet**	**Fondet**	**Koha e nevojshme**	**Treguesit e suksesit**
1. Organizimi i një takimi nga Grupi Iniciator për të identifikuar zonat në të cilat komuniteti është i gatshëm të marrë pjesë për kryerjen e përmirësimeve në zonën pilot.	**Roli kryesor:** Grupi Iniciator	Kontribute të komunitetit	Mars 2010 pika 1	Më pak femijë të cilët luajnë në rrugë
2. Arritja e një marrëveshjeje lidhur me veprimet e mundshme që do të ndërmerren nga komuniteti, p.sh. përcaktimi i zonave që mund të përdoren për pushim, identifikimi i hapësirave publike që mund të fitohen si rezultat i zhvendosjes së rrethimeve të banesave, krijimi i zonave të gjelbra të kombinuara me sheshet e lojërave për fëmijë, ndriçimi etj..	Shoqatat e komunitetit	Bashkia	Prill-Maj 2010 pika 2,3	Përmirësimi i cilësisë së jetesës
3. Zgjedhja e përfaqësuesve të komunitetit që do të zhvillojnë detajet e projektit në bashkëpunim me grupin iniciator dhe do të marrin përsipër organizimin e hapjes së hapësirave publike.	Bashkia	Donatorë të mundshëm të huaj apo vendas. OJQ		
4. Detajimi i një plani veprimi si shembull pilot i përmirësimeve nëpërmjet pjesëmarrjes së komunitetit. Ky plan do të përmbajë gjithashtu edhe kostot dhe afatet kohore.	Perfaqesues të biznesit		Qershor 2010 pika 4	M² të sipërfaqes se hapur
5. Paraqitja e këtij plani komunitetit dhe përcaktimi i fondit të bashkisë për investimet përkatëse sipas prioriteteve të komunitetit.	Zyra e urbanistikës		Qershor 2010 pika 5	
6. Angazhimi i Bashkisë dhe komunitetit dhe rënia dakord për hapjen e hapësirave publike.			Gushti-Dhjetor 2010 pika 6	